

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrale online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Përmbajtja / Sommario

(Numër i kushtuar figurës dhe veprës së Emanuele Giordano-s)

| | |
|--|-------------|
| BIOGRAFIA E ZOTIT EMANUELE GIORDANO (1920-2015) | faqe 3- 4 |
| EDITORIALI Drejtori | faqe 5 |
| NGA ‘FJALIMET E LIPIT’ Donato imzot Oliverio, Angelo Catapano, Alessandro Rennis, Caterina La Rocca, Vittorio Giordano | faqe 6-10 |
| KUJTIMI I AMBASADAVET SHQIPTARE NË ITALI E NË VATIKAN Neritan Ceka, Ardian Ndreca | faqe 11 |
| KUJTIME E RRËFIME KA ARBËRIA Nik Pace, Antonio Bellusci, Kostandin Bellushi, Ferdinando Elmo, Paolo Borgia, Francesco Fusca, Zef Chiaramonte, Carmine Stamile, Vincenzo Cucci, Zef Schirò di Maggio, Mario Massaro, Zef Kakoca, Pierfranco Bruni | faqe 12-30 |
| KUJTIME, MBRESA, STUDIME NGA BOTA SHQIPTARE Lush Gjergji, Odette Luoise, Imri Badallaj, Bardh Rugova, Merita Sauku-Bruçi, Klara Kodra, Emil Lafe, Helena Grillo, Vilma Proko (Jasezhiu) | faqe 31 -44 |
| AKTE KUVENDES MBI VEPRIMTARINË E ZOTIT EMANUELE GIORDANO | |
| Kuvend “Nderim papas Jordanit” (Frasnitë 1996) Gennaro Cortese, Spiro Kalemi, Italo Costante Fortino, Alessandro Rennis, Agostino Giordano | faqe 45-60 |
| Kuvend “Presentazione della II* Edizione del “Fjalor” (Frasnitë 2000) Francesco Fusca | faqe 61 |
| Kuvend “Vepra fetare dhe kulturore e protopapazit Emanuele Giordano (Frasnitë 2006) Eleuterio F.Fortino, Nik Pace, m.v.Maria Lucia, Imri Badallaj, Italo Costante Fortino, Agostino Giordano | faqe 62-78 |
| BIBLIOGRAFI E EMANUELE GIORDANO-s (1947-2014) | faqe 79-92 |
| BIBLIOGRAFI MBI VEPRIMTARINË e EMANUELE GIORDANO-s | faqe 93-94 |
| NDERIMET E EMANUELE GIORDANO-s | faqe 95 |
| E-MAIL, TELEGRAME, LETRA PËR VDEKJEN E ZOTIT MANOL | faqe 96-109 |



Protopresbiteri Emanuele Giordano
(Frasnitë 1920 - Ungër 2015)

Jeta 

Semestrare online
di Cultura
e Informazione Arbëreshe,
in Italia e nel Mondo

Arbëreshe

Revistë gjashtëmujore online e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”,
Purçill / Eianina (Cs-Italia)
Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001.

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**
Drejtori, Redaksi e Administratë / Direzione, Redazione,
Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)

Tel.: (+39) 345-3124376 / e-mail: jetarbreshe@libero.it / **sito internet:** <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Për të jipen dhurata / Per eventuali Donazioni in denaro, Iban: IT 22 H 07062 70850 000000116918, intestato a:
Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina/Purçill (Cs-Italia).

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografij, edhe ndëse s’botohen, nëng priren prapë /Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono.

Drejtorja nëng është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati.

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati.

Emanuele Giordano: Jeta e nji prifti Arbëresh

(Frasnitë 1920-Ungër 2015)

Lehet Frasnitë (Cs) ndër 27 të theristiut 1920 ka Agostino Giordano e Rosina Bilotta. Stërnip i papas Binard Bilotës (1843-1918 / kryeprift i katundit, poet e letrar), Manuelli bën skollat e para Frasnitë dhe ndër 1933 hyn te Seminari “Benedetto XV” i Grottaferratës (Rromë), ku vijon me skollën e mesme dhe gjimnazin. Pëstaj, në vitin 1938, shkon Rromë, te “Kollexhi Grek”: këtu bën studimet licealë, e pra ata filozofikë e teologjikë pranë Universitetit Papësor “Angelicum”, ku gavnjën edhe Liçenxën në Teologji. Në Kollexhin Grek, ditën 18 të shënmartirit 1945, ‘merr meshën’ dhe, ndër 30 maj 1946, vjen ëmruar famullitar / prift i Ejaninës ka peshkopi Janj Mele: këtu këndon të parën meshë ndër 16 të llonarit, festë e Shën Mërisë së Kärmanit.

Çë ahirna, për zotin Manuell, zë një punë e gjatë dhe e rëndë, çë po i dhuron më shumë gëzime se durime. Nën dorën e tij, e vogla Ejaninë i jep Eparkisë së Ungrës 7 priftra bixantinë (Selvaggi, Forestieri, Blaiotta, Aluise, Pace, Randelli, Carlomagno); 3 këllogjërëshe (1 basiliane bixantine, Scornavacca / 2 lëtire: Lo Frano, Bolpagni /, 1 këllogjër kapuçin: Caputo). Papas Manoli për dhjetra vjet bashkëpunon me areks në Eparki: si arbëresh çë do arbërishtin ndër gjithë Qishat Bixantine; dhe pëstaj, mbrënda “Komisjonës Liturgjike, të Muzikës Bixantine dhe të Artit të Shëjtë”, si një çë di e prier ‘lehtë e mirë’ tekstet grekë e italianë në gjuhë arbëreshe. Profesor tek “Institutit i Shkencavet Relixhoze G.Stamati”, mëson Liturgji, Kristologji, Eklesiologji, Gjuhë Greke, Gjuhë Arbëreshe, Muzikë Bixantine. Shumë vjet më parë se t’ish e botuar arbërisht në formë definitive nga Eparkia e Ungrës (1968), Mesha e Shën Janj Gojartit adhe këndohej arbërisht, në Ejaninë, e pjerrë arbërisht ka zoti Manuell. Te kjo Famulli e vogël, këndimi bixantin, grek dhe arbëresh, është bukë e çdo ditje, në çdo pjesë Liturgjike.

Qisha e famullisë, e kushtuar Shën Vasilit të Math, në vitin 1947, ndër të parat e Eparkisë,

EMANUELE GIORDANO: LA VITA DI UN PAPAS ARBËRESH (Frascineto 1920-Lungro 2015)

Nasce a Frascineto(Cs) il 27 giugno 1920 da Agostino Giordano e Rosina Bilotta. Pronipote di Papas Bernardo Bilotta (1843-1918 / arciprete del paese, poeta e letterato), Emanuele frequenta le Scuole Elementari a Frascineto e nel 1933 entra nel Seminario “Benedetto XV” di Grottaferrata (Roma), dove continua con la Scuola Media e il Ginnasio. Poi, nel 1938, si trasferisce a Roma, al ‘Collegio Greco’: qui compie gli studi liceali, e poi frequenta Filosofia e Teologia all’Università Pontificia ‘Angelicum’, dove consegue anche la Licenza in Teologia. Nel Collegio Greco, il 18 novembre 1945, viene ordinato sacerdote, e il 30 maggio 1946 viene nominato parroco di Eianina dal vescovo di Lungro Giovanni Mele: qui fa il suo ingresso, e canta la sua prima S.Messa, il 16 luglio 1946, festa della Madonna del Carmine.

Da allora, per papas Emanuele, comincia una missione lunga e difficile, che però gli regala più gioie che dispiaceri. Sotto la sua mano, Ejanina dà all’Eparchia di Lungro ben sette preti bizantini (Selvaggi, Forestieri, Blaiotta, Aluise, Pace, Randelli, Carlomagno); 3 monache (1 basiliana bizantina, Scornavacca; e 2 di rito latino, Lo Frano, Bolpagni), 1 frate cappuccino (Caputo). Papas Emanuele per decenni collabora in Eparchia con entusiasmo: come arbëresh che vuole la lingua arbëreshe in tutte le Chiese Bizantine; e poi, nella ‘Commissione Liturgica, di Musica Bizantina e dell’Arte Sacra’, come uno che sa tradurre agevolmente e con competenza i testi greci e italiani in lingua arbëreshe.

Docente all’Istituto di Scienze Religiose G.Stamati’, insegna Liturgia, Cristologia, Ecclesiologia, Lingua Greca, Lingua Arbëreshe, Musica Bizantina. Molti anni prima che venisse pubblicata nella sua forma definitiva arbëreshe dall’Eparchia di Lungro (1968), la S.Messa di S.G.Crisostomo si cantava già in arbëresh, a Ejanina, tradotta in arbresh da papas Emanuele. In questa piccola Parrocchia, il canto bizantino, greco e albanese, è pane di tutti i giorni, in ogni funzione liturgica.

La Chiesa della Parrocchia, dedicata a S.Basilio Magno, nel 1947, tra le prime dell’Eparchia,

zbukurohet me Ikonostazin bixantin; gjatë vitevet, pra, ndërron qaramidhe e pikurë të jashtme; ndër vitrat '90, pëstaj, edhe àsterkun zbukuron me marmur. Shpia Kanonike, edhe ajo e stisur ndër vitrat 1948-49, është shpia e zotit Manuell: këtu, ditë e natë venë e vijën gjindë të katundit, miq, gjitonë, gjiri; prifra e bulerë: kush për vuli e kush për mësim, kush për nevoja të ndryshme: Shumë gjenerata djemsh e vashash zoti Manuell merr për dorje e i shoqëron gjatë fazavet të jetës së tyre. Ture i mësuar katekizëm, këndime e gjuhë arbëreshe; ture predikuar e ture mbajtur korse mistagogjikë. I mbësos si rrohet. Shpia e tij është qendër kulture e vatër miqsh.

Te viti 1969 zoti Manuell bekon me gëzim hapjen e Vëllazërisë së Motrave të Vogla të Jisuit: i lypset mësim e praktikë gjuhje e kulture arbëreshe e shqipe, për misionin e tyre në Shqipëri, botë ateiste e komuniste.

Në vitin 2009, pas 63 vjetsh të ndëndura, si prift i Ejaninës, zoti Manuell shkon në pension e vete rron me të nipin Gustin, 'Nën katund', te një shpi në mes të naturës. Vitrat zënë e i mbëshojën e sëmundjet e ngasën më se një herë; po me fuqinë e lutjes dhe të vëlimës, nëng këcen një të Diel pa vatur mbë Qishë, i shoqëruar ka i nipi Ndon, për të kënduar Meshën: te Qisha e Shën Vasilit të Math, te Qisha e tij. E prasmja herë ndodhet ditën 14 vjesht 2014, festa e Shëjtës Kriqe (!). Tek ajo Meshë e sprasme, mbë Qishë hin e del me këmbët e tija, pa ndihmën e mosnjeriu, veç shkopit.

Pas një 'të shkarë' të papritur, ditën e Shën Ndonit Abat, 17 janar 2015, veket te spitali i Rrusanës për operacionë kirurgjike te kukuni e djathtë, por komplikacione të ndryshëm ja presen udhën shërimit. Shkuar tek "Don Milani", Ungër, për t'prirëj t'ëcnej, pas një muaji dhëmbjesh e durimesh e mjekimesh, ditën 17 fjavat, në herën 3 të natës, zoti Manuell lë këtë jetë. Gjithënjëhërje, i ngushëlluar ka infermjërët e natës. Pa zhurmë. Qasur 95 vjet. I mbjakur në kurm, adhë trim me krye. Do të jenë shëmbulli dhe veprat e tij që do të bëjnë zhurmë ndëpër Botën Arbëreshe, e jo vet.

Zoti Manuell s'ka merita vet në lëmin e fesë. Njetër aq, sadopak, i ka edhe në lëmin kulturor arbëresh.

viene abbellita con Iconostasi Bizantina; negli anni poi cambia copertura e pittura esterna, e poi ancora il pavimento viene abbellito col marmo. La Casa Canonica, anch'essa costruita negli anni '48-'49, è la casa di papas Emanuele: qui giorno e notte vanno e vengono gente del paese, amici, vicini e parenti; sacerdoti e personalità: chi per consiglio e chi per apprendimento, chi per necessità diverse: culturali, religiose, amicali o alimentari.

Molte generazioni di ragazzi e ragazze papas Emanuele prende per mano e accompagna lungo le fasi della loro vita. Insegnando loro catechismo, canti e lingua arbëreshe, predicando e tenendo corsi mistagogici. Insegna loro a vivere. La sua Casa è Nel 1969 papas Emanuele benedice con gioia l'apertura di una Fraternità di Piccole Sorelle di Gesù, a Eianina: hanno bisogno di apprendere lingua e cultura arbëreshe, per prepararsi alla loro missione in Albania, terra atea e comunista.

Nel 2009, dopo 63 anni intensi, come parroco di Eianina, papas Emanuele si dimette e va a vivere col nipote Agostino, "Sotto paese", in una casa in mezzo alla natura. Ma gli anni cominciano a pesargli e le malattie lo toccano più di una volta; ma con la forza della preghiera e della volontà, non salta una Domenica nell'andare in Chiesa, accompagnato dal nipote Antonio, per cantare la Messa: nella Chiesa di S.Basilio Magno, la sua Chiesa. L'ultima volta è il 14 Settembre 2014, festa della S.Croce (!). In quell'ultima S.Messa, in Chiesa entra ed esce con le proprie gambe, senza l'aiuto di nessuno, a parte il bastone.

Dopo una 'caduta' inaspettata, il giorno di Sant'Antonio Abate, 17 gennaio 1915, si va in ospedale a Rossano per l'operazione chirurgica al femore destro, ma diverse complicazioni rendono difficile la guarigione. Ricoverato al "Don Milani" di Lungro per cure riabilitative, e dopo un mese di dolori e sofferenze, e di cure, giorno 17 febbraio, alle ore 3 del mattino, papas Emanuele lascia questa terra. All'improvviso, consolato dagli infermieri di turno. Senza far rumore. A quasi 95 anni di età. Invecchiato nel corpo, ma ancora giovane con la mente. Saranno il suo esempio e le sue opere a far rumore nel Mondo Arbëresh, e non solo.

Papas Emanuele non ha meriti solo in campo religioso. Quantomeno altrettanti ce l'ha anche in campo culturale arbëresh.

Bùartim shumë, po s'dimi sa

Një djalë që lehet nën malet e Frasnitës është *in ngurët*; ndëse lehet ka një mëmë arbëreshe, është *arbëresh*; ndëse ka një tat këngëtar, është *këngëtar*; ndëse për von 'prej së vogli' si kulloten bishtrat, rritet *in thjeshtë*; ndëse pra lehet të pëllasi i një prifti stër-lalë, i stisur dhjaj përpara Qishës së katundit, patjetër *do t'i pëlqenjë priftëria*.

Ka 'udha e Pulinit' tek 'udha e Priftërisë': 20 metra ndajën shpinë e djalit Manuell ka Qisha e Frasnitës. Një fat i shkruar. E prift u bë. Delar njerëzish.

Prift, i ngurët, arbëresh, këngëtar, i thjeshtë. E i urtë.

'Bir i Frasnitës, prift i Ejaninës, arbëresh i math': mbishkrimi i varrit tij. Fjalët ja zgjodha të thjeshta. Si ish ai. Dhe me kryet ka lehet dielli. Ka erhtëtim na: të lirë, trima, të krishterë, bixantinë, arbëreshë.

Për sa vlenej, rroi pak. Për sa doj (e mund) t'kish edhe punuar, qe një bjerrje e rëndë. Vitra kish pothuaj 95, po si i rroi ai, "ndënd e vër", çdo ditë e shtridhi njera tek palsit e ashtit. Për 'të, dita mbaronej me tri orë natë e zënej më parë se të këndonej gjeli. Një jetë këllëgjiri. E ndajtur kátrish: lutje, mësim/pritje gjindsh, studim, shkrim.

Një prift arbëresh. I gieshur te mägjja e Vangjelit: me brumin e Meshës, me ujit e këngës, me kripën e fjalës, me djerst e delarit, me mjaltë e mikpritjes. E furri që piq vet bukë të bekuar.

Kush erth Ejaninë se t'gjënej gjuhëtarin o historiánin, filològun o shkencëtarin, s'e gjet. Gjet vet zotin Manuell. Një prift t'urtë. Jo sepse s'mundi; s'dish. Misioni i tij ish i gjerë, jo i ngushtë; ish për gjithë, jo për pak; për popullin, jo për shkencën. Bëri si arza: muar këtu këtë atë ç'i duhej e fjeturoi gjetkë: mjaltë s'i duhej për vetëhenë, po për misionin priftëror. për bestarët e për priftrat e Eparkisë. Qe gjuhëtar e poet sa i sosi, filolog e historian sa i sosi, muzikolog e leksikograf sa i sosi, etnograf e gazetar sa i sosi. Për t'ish një prift i mirë. Një prift arbëresh bixantin i mirë. Sa më i mirë.

Stisi Ikonostazën më parë se të tjerë; pruar arbërisht Meshë e Himne grekë, e i këndoi mbë Qishë, më parë se t'lehej Vatikani II; kish hirin e 'delarit të mirë', po s'qe i vlerësuar si duhej; bëri një Fjalor arbëresh, te qetësia. I pëlqenjë të bashkonej, jo të ndanej. I pëlqenjë puna, jo parastoqet. I ngurët si malësor, i butë si pak. Këtë numër ja dhuronj Atij. Zotit-lalë. E meriton. Te dita e të lerit ' tij: 27 theristi.

E do të jetë festë e madhe në Parrajs.

Drejtori

ABBIAMO PERSO MOLTO, MA NON SAPPIAMO QUANTO - Un bambino che nasce sotto i monti di Frascineto, cresce *forte*, se nasce da una madre arbëreshe, *arbëresh*; se ha un padre cantore, *cantore*; se prova, da piccolo, come si pascolano i capretti, cresce *semplice*; se poi nasce nel palazzo del pro-zio prete, situato proprio di fronte alla Chiesa del paese, senz'altro *gli piacerà il sacerdozio*.

Da 'via Pollino' a 'via del Sacerdozio': 20 metri separano la casa del piccolo Emanuele dalla Chiesa di Frascineto. Un destino già scritto. E prete si fece. Pastoredi uomini. Prete, forte, arbëresh, cantore, semplice. E dotto.

'Figlio di Frascineto, parroco di Eianina, arbëresh grande: la scritta sulla sua tomba. Le parole le ho scelte semplici. Com'era lui. E con la testa verso oriente. Da dove siamo venuti noi: liberi, valorosi, cristiani, bizantini, arbëreshë. Per quanto valeva, è vissuto poco. Per quanto avrebbe voluto (e potuto) lavorare, è stata una grave perdita. Aveva quasi 95 anni, ma come li hai vissuti lui, molto intensamente, ogni giornata l'ha spremuta fino all'osso. Per lui, il giorno finiva tre ore dopo il tramonto e iniziava prima che cantasse il gallo. Una vita da monaco. Divisa in quattro attività: preghiera, insegnamento/accoglienza, lettura/studio, scrittura.

Un papas arbëresh. Impastato nella madia del Vangelo: col lievito della Messa, con l'acqua del canto, col sale della parola, col sudore del pastore, col miele dell'ospitalità. E il forno che cuoceva solo pane benedetto.

Chi, negli anni, venne ad Eianina per cercare il linguista lo storico, il filologo o l'uomo di scienza, non lo trovò. Trovò solo papas Emanuele. Un prete dotto. Non perché non poté; non volle. La sua missione era estesa, non ristretta; era per tutti, non per pochi; per il popolo, non per la scienza. Fece come l'ape: prese qui e lì quel che gli occorreva e volò altrove: il miele non serviva a lui ma alla missione sacerdotale: per i fedeli e i sacerdoti, dell'Eparchia. E' stato linguista e poeta quanto gli è bastato, filologo e storico quanto gli è bastato, musicologo e lessicografo quanto gli è bastato, etnografo e giornalista quanto gli è bastato. Per essere un buon prete. Un prete arbëresh bizantino. Possibilmente ottimo. Costruì l'Iconostasi prima di altri; tradusse in albanese, e li cantò in Chiesa, Messa e Inni bizantini, prima che nascesse il Vaticano II; aveva il carisma del 'buon pastore', ma non fu valorizzato al meglio; compilò un Dizionario Arbëresh, nel silenzio; gli piaceva unire, non dividere. Gli piaceva il lavoro, non le chiacchiere.

Duro come un montanaro, buono come pochi.

Questo numero glielo offro a Lui. Al 'Reverendo Zio'. Se lo merita. Nel giorno del suo compleanno: 27 giugno.

E sarà festa grande in Paradiso.

Fjala e Peshkopit, te Mesha e përkujtimit *

“Sytë tanë e kërkojën edhe nanì, po s’e përpjekën”

È trascorso più di un mese dalla morte di Zoti Emanuele. Vogliamo dire con Sant’Agostino: “I nostri occhi, nel frattempo, lo hanno cercato e lo cercano tuttora, senza incontrarlo”. Ecco, la sua mancanza pesa, eppure la sua presenza in questa Chiesa si avverte. La realtà si impone in tutta la sua durezza e non possiamo esimerci di accettarla; e ci chiediamo: ‘Dove sarà, cosa farà, come starà?’. La risposta la troviamo nel Vangelo di oggi: “Non è morto, ma dorme”. La fede nel Signore della vita, vincitore della morte, ci guida verso la speranza, in virtù della quale continuiamo ad amare Dio, provvidente ed imperscrutabile. Illuminati dalla speranza, ci uniamo alla comunione dei santi. La certezza che esiste un legame tra i battezzati, ci induce a passare attraverso la preghiera per Zoti Emanuele: unico modo per raggiungerlo, e creare quella comunione che ci unisce con coloro che non ci sono più.

Ed è per questo motivo che parlando ‘di lui’, continuiamo a parlare ‘con lui’. Vogliamo dire oggi quanto l’Eparchia di Lungro gli sia debitrice, in quanto molti nostri confratelli, il loro sacerdozio lo debbono in gran parte a lui; e l’aver contribuito a dare più sacerdoti alla Chiesa, alla Diocesi, gli sarà ascritto a salvezza. Vogliamo ricordarlo così, mentre ci dice di non fermarci mai, di andare avanti, così come ha fatto Lui, che per oltre 60 anni ha servito questa comunità, come umile e semplice operaio nella vigna del Signore. In tutti questi anni ha annunciato e predicato il Vangelo, ha battezzato, ha cresimato, ha confessato, ha celebrato l’eucaristia, ha unito in matrimonio, ha accompagnato tanti fedeli; ha mantenuto la fede. Anni svolti al servizio della Chiesa e della Cultura italo-albanese. Non possiamo non ricordare i tanti anni al servizio della Diocesi, come professore dell’Istituto di Scienze Religiose; in particolare ha insegnato liturgia bizantina e lingua albanese, agli oltre 300 alunni che si sono susseguiti nell’arco degli anni.

Sull’esempio del sacerdozio vissuto da Zoti Emanuele Giordano, figura carismatica e spiritualmente attraente, nelle comunità arbëreshe si avverte il bisogno di riscoprire l’alta funzione del sacerdote, che si riveste del ruolo di seminatore

Donato imzot Oliverio

Peshkopi i Ungrës (Cs)

I NOSTRI OCCHI LO CERCANO TUTTORA, MA SENZA INCONTRARLO - Shkoi më se një muaj ç’kur vdiq zoti Manol. Do’ t’thomi me Shën Gustinin: “Sytë tanë, ndërkaq, e kërkuan dhe e kërkojën edhe nanì, po s’e përpjekën”. Një, mungësa e tij mbëshon, po, megjithatë, ndihet se ai nanì është këtu, bashkë me ne, te kjo Qishë. E vërteta është një, dhe është e tharët, dhe na s’mund t’e reshtmi llargu ka na; e pyhemi: ‘Ku është, ç’është e bën, si rri?’. Përgjgëjjen e gjëmi te Vangjeli i sotshëm: “Nëng vdiq, po fjë”. Besa tek Zoti i jetës, çë mundi vdekjen, na udhëton drejt shpresës, me të cilën vazhdomi të duami mirë Tënzot, të kujdesshëm e të pakuptueshëm. Të dritësuar ka shpresa, i bëmi shoqëri bashkësisë së shënjtravet. Siguria se është një lidhje ndë mes të pagëzuarvet, na shtie të shkomi ndëpër lutjen për zotin Manol: vet kështu mund e ‘rremi tek ai e të krijomi atë bashkësi çë na lidhen atyrëve çë s’janë më.

E vet kështu na, ture folur ‘mbi të’, vijomi të folmi ‘me të’. Do të thomi sot sa Eparkia e Ungrës është e dëtyruame me ‘të, sepse shumë ndër ne zotra udhën e priftërisë së tyre e muartin falë atij; e, sepse bëri çmos sa t’i jipë “sa më priftra” Qishës, Eparkisë, do të jetë për ‘të një meritë për shpëtimin e tij. Duami t’e kujtomi kështu, ndërsa na thot të mos qëndromi, të vemi përpara: si bëri ai, çë për 63 vjet shërbei këtë bashkësi, si një punëtor i përlur dhe i thjeshtë te vreshta e t’Inzoti. Te gjithë këta vjet lajmëroi e predikoi Vangjelin, pagëzoi, krezmoi, skomollisi, celebroi Kungimin, martoi, shoqëroi shumë bestarë, mbajti besën e krishterë. Vitra të shkuar ture shërbier Qishën dhe Kulturën Arbëreshe. S’mund mos kujtomi gjithë vitrat në shërbim të Eparkisë, si profesor i ‘Institutit të Shkencavet Fetare Janj Stamati’: mësemë Liturgji bizantine e Gjuhë arbëreshe i mësoi 300 (e më) studentëve çë u pasuan njeri pas jetrit, ndër vitrat.

Pas shëmbullit të priftërisë së rruar ka zoti Manol Giordano, figurë me hir dhe shpirtërisht magjepsë, ndër bashkësitë arbëreshe ndihet nevoja të ri-zbulohet puna e lartë e priftit, çë veshën rolin e

quotidiano di principi, che sono destinati a diventare la base della vita che contraddistingue il Cristiano.

Il contributo maggiore dato dal protopresbitero Emanuele alla cultura arbëreshe consiste nella compilazione del Fjalor i Arbëreshëvet t'Italisë, Dizionario degli Albanesi d'Italia, così come la traduzione in lingua arbëreshe dei quattro Vangeli, così come l'apporto dato da Zoti nel campo musicale, tanto bizantino quanto tradizionale albanese.

La trasmissione del pensiero attraverso la lingua materna, - sosteneva con molta passione - ha risonanze particolari di penetrazione nell'animo della gente, ciò che costituisce un canale pastorale privilegiato.

È un'eredità grande, ma anche pesante, quella che ci ha lasciato: si deve raccogliere in un'Opera Omnia, magari anche attraverso l'uso di mezzi multimediali. Questi pensieri l'odierna Commemorazione mi suggerisce.

Ci prepariamo a celebrare la Pasqua, la Resurrezione di Nostro Signore Gesù Cristo: "Venite, prendete la luce dalla Luce che non tramonta". È il primo inno - l'invito della Pasqua - di quella straordinaria pubblicazione di Zoti Manol (*Himne Liturgjike Bizantino-Arbëreshe*): un sussidio indispensabile per vivificare le celebrazioni liturgiche dell'intero anno.

mbjellsit ditullor të atyre parimeve që pra do të jenë themelet e jetës që shënon të Krishterin.

Kontributi më i math që zoti Manol i dha kulturës arbëreshe qëndron *Fjalori i Arbëreshëvet t'Italisë*, kështu si të pjerrit arbërisht të *Katër Vangjelevet*, ashtu si edhe në lëmin e *Muzikës*, aq qishtarë bixantine sa të zakonit popullor arbëresh.

Transmetimi i mendimit të 'gjuha e mëmës' – thonej me shumë mall – ka një jehonë të veçme e të thellë të zëmra e të shpirti i gjindjes: është udha baritore më e mirë, më se gjithë të tjerat.

Është një Trashgim i math, po edhe i rëndë, ai që na la: do mbjedhur tek një "Vepër e Përgjithshme" (Opera Omnia), edhe me ndihmën e mjeteveve elektronikë.

Këta janë mendimet që ky Përkujtim i sotshëm më këshillon.

Jemi po të festojmi Pashkët, Ngjalljen e Zotit tonë Jisu Krisht: "Ejani, mirrni dritë nga Drita e pashuarshme". Është i pari himn - 'ftesa e Pashkëvet' - i atij libri të rrallë të zotit Manol (*Himne Liturgjike Bizantino-Arbëreshe*): një ndihmë e domosdoshme për të gjallërojmi krentrimet liturgjikë të tërë vitit.

* *Ejaninë, Famullia e Shën Vasilin të Math, E Shtunja e Llàxarit, 28 mars 2015, katërdhjetori i vdekjes.*

Fjalimi i Kryetarit të Frasnitës

“IL GIORDANO”: un Fjalor fondamentale e insuperato.

Angelo Catapano

kryetari i Frasnitës (Cs)

Eccellenza, Reverendissimi parroci, colleghi sindaci, concittadini e tutti voi convenuti,

È una giornata di perdita per le comunità di Eianina e Frascineto, per l'Eparchia di Lungro e per il mondo albanese, perché uno dei suoi Paladini più tenaci, il reverendissimo e caro protopresbitero 'zoti Manuell', ha terminato il viaggio terreno per incamminarsi e riposare nelle tende dei Giusti, in quel luogo del 'riposo' promesso che la sua parola di pastore, strumento di quella divina e scritturale, ha spesso menzionato proprio dal pulpito di questo sacro edificio, a consolazione di quanti sono stati privati dei propri cari dall'esperienza estrema della morte.

È non senza commozione che mi accingo a dare, anche a nome della comunità che mi pregio di rappresentare, l'estremo saluto a questa personalità brillante e poliedrica, a questo uomo di Dio, a questo uomo di Lettere, a questo uomo di Cultura che ha guidato, per circa sette decenni, il popolo di Dio di Eianina contribuendo, con impegno, studio e costante dedizione, ad edificare e rinsaldare il mondo culturale arbëresh.

Zoti Manuell e la sua opera sono stati punti di riferimento imprescindibili per tutti gli studiosi o i semplici appassionati di cose albanesi.

Figura eclettica e instancabile, ha sondato e approfondito quasi tutti gli ambiti della cultura di appartenenza, producendo interessanti studi di linguistica, di letteratura, di folklore. La passione per l'albanologia, passione di un'intera vita, lo ha portato a tradurre in lingua arbëreshe i Vangeli e le Epistole e a dare alle stampe il Fjalor, che per gli addetti ai lavori è 'Il Giordano', che rimane, ad oggi, uno strumento fondamentale e insuperato.

Negli anni Settanta, poi, si è cimentato nella felice esperienza di 'Zëri i Arbëreshëvet-La voce degli italo-albanesi', rivista che vide la luce qui ad Eianina e sulle cui pagine trovava espressione quel mondo intellettuale italo-albanese che prendeva coscienza di sé e si incamminava sulla strada della rivendicazione dei diritti.

Nella memoria di tutti è ancora vivo il melodioso suono della sua bella voce che cantava la Messa. A Zoti Manuell deve molto anche il mondo della musicologia in quanto, oltre ad aver messo su pentagramma buona parte dei repertori dei canti popolari italo-albanesi, ha prodotto interessanti studi sulla musica e sul canto bizantino, passando dalle semplici nozioni di musica bizantina all'analisi dei canti legati ai singoli momenti dell'anno liturgico.

Con la dipartita di Zoti Manuell, Frascineto, Eianina, l'Eparchia di Lungro e l'Arbëria intera perdono un pezzo della propria storia; ognuno di noi perde un pezzo della propria storia personale. Perché nella storia di ognuno di noi la figura di Zoti é entrata, in un modo o nell'altro.

Esprimo le mie personali condoglianze, e quelle della cittadinanza che rappresento, alla famiglia Giordano e, facendo mie le ultime parole dell'Ufficiatura dei Defunti, saluto con "Eterna sia la tua memoria!" questa figura che lascia tangibili e preziose tracce della sua esperienza terrena.

Fjalimi i 'Ungirnjòtit'

Zo', parkalès pir ne !**Alessandro Rennis**

muzikolog, ka Ungra (Cs)

L'ho chiamato sempre e semplicemente 'zot', perché così mi sembrava giusto a sintetizzare la sua vocazione – solida e profonda – per la cura delle anime a lui affidate, per l'impegno proficuo e solerte sul ruolo culturale di tutti gli Arbresh dentro e fuori i confini ideali dell'Arberìa, per la professionale conoscenza sua della musica bizantina, messa al servizio della autenticità del nostro Rito; e lui ricambiava con un altro semplice "Ungirnjòt", pronunciato con forza, in modo provocatorio, quasi a sollecitare perenne rapporto di amicizia e reciproca stima.

Ecco: 'zotin' e – credo – 'zoti', per tutti noi. Si parlava di tutto, 'me zotin'.

Certo, di musica bizantina, ma anche del nostro rito che - mi diceva - "Bada che non è solo un credo, ma è un modo di essere e di vivere la fede". Ultimamente, sempre più spesso, parlava di sé come di una vita ormai conclusa e si soffermava, con lucide e serene riflessioni, su come e perché accettare la morte da buon cristiano. E quando un giorno – quasi per distoglierlo dall'argomento – gli dissi: "...Certo, zo';parliamo così sempre della morte degli altri", mi rispose, quasi sorpreso di non essere stato capito: "...No....no...., parlo della mia!". Ma io avevo capito benissimo. Ecco perché ieri, a Lungro, attorno all'altarino approntato ad accogliere le spoglie mortali del caro 'zot', quando dai fedeli della sua Parrocchia si è elevato al Signore il mesto canto funebre secondo il nostro rito, non ho potuto trattenere una lacrima, che ho inteso fosse l'estremo omaggio ad una persona cara: omaggio più vero di queste mie povere parole; più profumato di affetti di ogni altro fiore depresso ai suoi piedi.

'Zoti' ci ha lasciati per salire al 'Padre di tutte le genti', ma non ci ha abbandonati nella terra senza speranza. Dall'alto, dai luoghi dove – come dice la nostra Liturgia – "non v'è né affanno, né gemito", continuerà a vigilare su tutti noi, perché era e resta 'zoti' per eccellenza. Sì, dopo aver tanto lavorato e scritto a gloria di tutta la nostra Diocesi, che perde – oggi – un autentico testimone di viva fede, ha scritto per noi anche l'ultima sua pagina di vita terrena e, a piè di pagina, sono costretto a leggere per la prima volta per esteso la sua firma: Papàs Emanuele Giordano, 'zoti'. Non potevamo chiedergli altro in vita, perché ha dato tutto se stesso: oggi però, a lui che vive nel cielo dei giusti, per questa nostra vita terrena chiediamo soltanto un: "...Zo', parkalès pir né!"; e tra questi ci sono anche io, zo': **Ungirnjoti**.

Fjalimi i njëi bestare

Caro Lalë Zoti ...

Caterina La Rocca

ka Frasnita (Cs)

Caro 'Lalë Zoti'... Sì, è proprio così, per tutti noi eri il nostro 'Lalë Zoti'. Caro Don Emanuele, nessuno di noi si aspettava che sarebbe arrivato questo momento, ma purtroppo, come dicevi sempre tu, la morte fa parte della vita: si nasce, si vive e si muore, siamo di "passaggio", dobbiamo avere sempre la "valigia pronta"; queste erano sempre le parole che ci ripetevi nei momenti di sconforto, dandoci nello stesso tempo tanto coraggio. Ora siamo qui, tutti uniti intorno a te, siamo tristi come gli Apostoli alla dipartita di Gesù; ma Egli fece una promessa, che quella tristezza si sarebbe trasformata in gioia. Questa è la nostra speranza, che la tristezza si tramuterà in gioia, sapendo che sarai in Paradiso e che tutto il bene che hai fatto a noi continuerai a farlo pregando per noi, e noi per te.

Caro Don Emanuele, non so dove iniziare prima a ringraziarti per quello che sei stato: non solo per l'intera comunità, ma anche per me. Mi hai accolto subito quando sono venuta a vivere qui, in questo piccolo paese, facendomi partecipare attivamente alla vita spirituale iniziando un cammino di fede insieme.

Grazie, Don Emanuele, per l'intensa attività Pastorale che hai svolto in questa comunità e per la salvaguardia, conservazione e valorizzazione dei beni artistici, storici e culturali della nostra Parrocchia.

Grazie per il tuo aiuto materiale e spirituale: nei momenti di difficoltà sei stato sempre presente con la tua parola di fede, che ci ha aiutato ad andare avanti nei momenti difficili. Vorremmo dirti ancora tante cose, ma le nostre parole sono sempre poche in confronto a quello che tu ci hai dato e ci hai insegnato.

Sei stato un grande uomo, un grande sacerdote, umile, discreto: un grande esempio per tutti noi e per tutti i tuoi successori.

Caro 'Lalë Zoti', caro Don Emanuele, ognuno di noi conserverà di te un ricordo tutto suo, particolare, unico, personale: così come particolare, unico e personale è stato il tuo rapporto con noi.

Grazie di tutto, 'Lalë Zoti'! Vivrai sempre in noi e rimarrai sempre nei nostri cuori.

Mesaxhi i stërnipit

Riposa in pace, Zoti La' !

Vittorio Giordano

gazetar, bir i Drejtorit

Riposa in pace, Zoti La' !

Ora potrai finalmente coronare il sogno di una vita: riabbracciare Nostro Signore, a cui hai dedicato un'intera esistenza.

Teologo, filosofo, sociologo, linguista, grecista, latinista, albanologo, scrittore, poeta, musicologo, ma soprattutto MAESTRO DI VITA!

Grazie al tuo esempio, ho capito che la semplicità e l'umiltà rappresentano la strada maestra per avvicinarci a Dio.

Ora prega per noi, dall'alto dei Cieli, tra quei Cherubini e Serafini che hai sempre invocato, con un pizzico di emozione, nelle tue celebrazioni liturgiche.

E gioisci, perché sei tornato al PADRE ETERNO! Noi, da quaggiù, non possiamo fare altro che ringraziarti per averci dedicato il tuo tempo, i tuoi sguardi, i tuoi sorrisi: così preziosi, così significativi.....

In tutta la mia vita ho sempre sentito la tua "protezione": uno schermo roccioso contro ogni male; adesso mi sento un po' più solo, in balia delle onde della vita! O forse no, tu sei ancora qui; ora sei addirittura il mio Angelo Custode!

TI VOGLIO BENE, Zoti La', e scusa se non te l'ho detto spesso!

Ciao ciao! Anzi... ARRIVEDERCI !

It nip Vitòri

Meritat e tij janë të mëdha

prof. dr. Neritan Ceka

Ambasador i Shqipërisë në Itali

AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
- ITALI -

Një telefonatë nga sen. Basilio Giordano më bëri të njohur se “zot Emanuele Giordano na la”. M’u shfaq menjëherë në kujtesë takimi i fundit me zot Manolin, në taracën e shtëpisë së nipit Gustin, në Ejaninë, ku jemi fiksuar në një foto. Dukej plot shëndet dhe pata përshtypjen se do të jetonte gjatë, në efektin e atij ajri të pastër që zbriste nga masivi i Pollino-s përballë. Folëm për Fjalorin e tij të botuar që më 1963, që është një thesar i gjuhës, por edhe një enciklopedi e shprehjeve të shkrimtarëve arbëreshë; për Gramatikën e gjuhës arbëreshe, që botoi më 2005; për Abetaren arbërisht, por edhe katër Ungjijtë e përkthyer në arbërisht, me një synim të vetëm: që të krijonte themelet e një Gjuhe normative të Arbëreshve të Italisë. Ai burrë i imët ishte një vullkan dashurie dhe përkushtimi për popullin e tij, si kryeprift në Kishën e Shën Vasilit të Ejaninës. Stërnip i shkrimtarit dhe priftit patriot Bernard Bilotta, përshkoi rrugën e përgatitjes profesionale dhe shpirtërore në Seminarin Benedikti XV të Grotaferratës dhe Kolegjin Pontifik Grek të Romës, për t’u lauruar në teologji në Universitetin Pontifik “Angelicum” të Romës. Shtatëdhjetë vjet më parë filloi punën si famulltar në Ejaninë dhe do të ishte nga të parët që do të meshonte në gjuhën arbëreshe. Pothuaj dhjetë vjet punë do t’i kushtonte “Fjalorit të Arbëreshëve të Italisë” (1963). Më 1966 pa për herë të parë Shqipërinë, i ftuar për të mbajtur një leksion mbi Bernard Billotën në Universitetin e Tiranës. Me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, dhe si një detyrim ndaj lalës të tij, botoi më 1967 poemën e Bernard Billotës “Shpata e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë”. Më 1972 mori drejtimin e revistës “Zëri i Arbëreshvet”, ku botoi, ndër të tjera, edhe komedinë “Dorëngushti” (Kopraci), si për t’i dhënë lexuesve arbëreshë një shembull të një Arbërishte të kulluar. Talentet e tij përfshinin edhe muzikën, duke lënë edhe një vepër që përmbledh tekstet dhe partiturat e disa dhjetra këngëve arbëreshe. Atje, në bisedën në terracën e shtëpisë së A.Giordanit, në

Humbja e tij, një zbrastë

prof. dr. Ardian Ndreca

nga Ambasada e Shqipërisë në Vatikan

AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
- VATIKAN -

Me hidhërim morëm vesh për kalimin në amëshim të mikut dhe studiuesit të shquar të kulturës arbëreshe, papas Emanuele Giordano.

Veprimtaria e tij në të mirën e shkencës albanologjike, botimet kritike, veprat origjinale, ndër të cilat vegojmë Fjalorin e mirënjohur, kanë kontribuar në zgjimin dhe në përparimin e kulturës arbëreshe.

E kujtojmë me përmallim dhe i shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes të të ndjerit, famullisë së Ejaninës, Eparhisë së Ungrës dhe gjithë Bashkësisë së studieve arbëreshe, të sigurtë se humbja e tij do të lërë një zbrastë në lëmin e studimeve arbëreshe.

Me nderim të thellë

Ardian Ndreca
i ngarkuar me punë

Ejaninë, e pata pyetur se kush e kishte bërë muzikën e mrekullueshme të poezisë së famshme të zot Pietro Kamodekës, “Petkat e të mirat tona”. U befasova kur më tha, me modestinë më të madhe, se muzika ishte e tija.

Zot Manoli s’është më. Mbeten veprat e tij, që janë edhe udhërrëfytes për të gjithë ata që e duan Arbërinë dhe Arbërishten me dashurinë e trashëguar prej tij. Ata që qenë më afër tij, Vasili dhe Agostini, por edhe zot Anton Belushi: dishepuj të denjë të Bernard Billotës, Manoli Giordanos, Viçenc Dorsës, Dushko Vetmos, Vorea Ujkos dhe burrave të shquar që ka nxjerrë Frasnita dhe Ejanina. Të shpresojmë që arbëreshë të tjerë do të rreshtohen në këtë plejadë të ndritshme, për të ndjekur porosinë e Bernard Billotës: “Bëni kujdes që ta studioni, ta flisni dhe ta shkruani mirë këtë Gjuhë Arbëreshe, sepse kështu do t’i jepni vendin që meriton në mes të gjuhëve të Botës dhe do tua rekomandoni intelektualëve të huaj, që do të dinë ta vlerësojnë”. Zot Manoli meriton plotësisht vlerësimin që i pati bërë Lalës të tij të shquar: “...Meritat e tij ndaj gjakut të shprishur arbëresh dhe ndaj Shqipërisë kanë qenë e janë të mëdha. Dhe emri i tij do të kujtohet e lëvdohet nga gjithë arbëreshët dhe nga Mëmëdheu, që e deshi dhe nuk e harroi kurrë”.

Zoti Emanuel, famullitëri im

protopresbiteri Nik Pace

purçilot, famullitar i Qishes së Shën Nikollës, Lecce

Zoti Emanuel ka qenë, për shumë nga ne, një figurë referimi për formimin human e kristian.

Për mua ai ka qenë sigurisht personi që, bashkë me prindërit e mi, ka karakterizuar personalitetin tim.

Ai ishte, dhe është, një mjeshtër jete e besimi, të cilit ishte e vështirë t'i rezistojë: me thjeshtësinë që e dallonte, ai ishte në gjëndje t'i fliste zemres së njerëzve e një keshill i tij godiste objektivin, e bënte në mënyrë që të pasqyrohej fytyra e Mjeshtërit të Vertetë, Redentorit.

Po, do të mendoj atë kur do të dua të deshmtoj që kam njohur një prift të kompletuar.

Do të më pëlqente ta krahasoja me figurën e mesazherit të prezantuar nga profeti Isaia, i cili në majë të maleve - e malet Zoti i donte - dërgonte me gëzim mesazhin e Zotit përtej kufijve... E ashtu si në një këngë të gezuar, që Zoti dinte të intononte, dhuron lavdi Zotit:

“ Sa të bukura janë mbi malet këmbët e lajmëtarit që sjell lajme të mira, që njofton paqen, që sjell lajme të bukura mbi gjëra të mira, që shpall shpëtimin, që i thotë Sionit:

"Perëndia yt mbretëron!". 52,7[Is 52,7]

Lavdëroni Zotin sepse është i mirë [Ps 136,1]

Faleminderit, Zoti Emanuel, që na keni trasmetuar gëzimin e besimit, që i jep kuptim jetës.

Kujtime si lule me mirënjohje, për lal-zotin Manòl

protopresbiteri Antonio Belluci

ka Frasnita (Cs)

1. Urata e lal-zotit Manòl

Kur lal-zoti Manol u bë prift dhe erdh Frasnitë në vitin 1945, u kisha njëmbëdhjet vjet. E mëma m'dergoi mb'krua ka Kroj Kràvarit me një gajdhure me di vucë të samari për t'mirrja ujë ka di pishotul të mbëdhenj ç'ishen atje. Gjithë gjindjat vejen atje ahirna, pse nd'katund s'kishem ujit mbi shpi. Kur vucët u mbjuan me ujë, cje Dellina Ngjanit ç'ish atje muar vucët e m'i vu mbi samarin e gajdhures, një kanjanë e një ka jetra anë, mbrënda te di terkuza. U nisa për t'veja ndi shpi. Udhë e udhë, afer ka udha e pondit, u llaskar nëngji terkuzes te një vucë, e gjithë samari me jetren vucë ish e bijen md'truall me gjithë gajdhuren. U vura e thërrita fort fort, sa më vuxh kisha te gërrlaci, sa të m'gjegjjen edhe timbat e malëve. Ish e shkonej lal-zoti Manol tek udha përsiper e m'gjegji. Erdhi karrera karrera e më ndihu dhe ndreqi samarin dhe vucëtë. Ai m'qeshi, m'shutarti ato di pika loti ndër faqe dhe iku. Ndë shpi ja thash mëmës dhe tatmadhit, lal Tumazi Llupaçit, dhe tatmadhi dhopu tri ditë m'suall ka mali di fishele me gjizë dhe një palaç i pështjellur me fiera. "Ndonù, ec e ja qell lal-zotit Manòl, pse ki është një prift shumë i mirë te zëmra. Me t'jatin, Gustinin, na duhemi shumë mirë. Ec mbjatu, dhe puthi doren dhe lipi uraten, se t'bën mirë. E gjegje? Mos e harro!".

2. Kopshti zotit-lal Manol

Purçill tek shpia ku rrinej lal-zoti Manol ish, dhe është, një kopsht si një parrajs, ku ai mbolli shegen, fikun, mindullen, arren, dardhen, kumbullen, gërrshinë dhe gjithë t'mirat. Kur veja e e gjëja ai, gjithë hare, ai m'qellnej te kopshti. I qeshnej zëmra dhe fjala tij bëhej e ëmblez si mjaltë. "Përvo këtë sheg sa e bukur është, përvo këtë dardhë sa e ëmbel është, mirr e ha këtë kullumber. I mbolla u me këto duar dhe disa dhe i nxitarta", m'thoj me zëmren pjot hare, ture shkuar kanjanë e kanjeter. "Sot hami këtu. Vemi e ziemi gjë dhe m'ndihen e bëmi gjë. Dhe menat nisemi e vemi bashkë nd'malt e prana priremi. Janë edhe tre o kater trima çë duan t'venë n'malt. Do t'vish? Vëmi një copez bukë dhe një copez djathë, një rrogjikez me verë, dhe nisemi e vemi. Vër këpuctë me taça e mos harro shapken dhe kaloqen, pse ka t'ngjitemi tek ato brinja njera lartë". "Vinj, vinj, lal-zò, mua m'pelqen shumë mali. Ato brinja e ato llaka i njoh mirë".

3. N'malt tek skaraci Lal Tallarikut

Menatet njize, kur te qielli zë e dil Pulàra, më përpara se t'dil Illi ditsë, u nistim gjithë me di trasta kalosh dhe me di bastune në dorë, me një shapk mbi krie, e pjot hare. Te një çik herë gjëndëshim ka Krivi. Ture ngjitur ato timba si dhì t'egra, karrera karrera, u gjëndtim ka Llaka Maries, ku lal Frangjisku Tallarikut nd'veret kish skaracin me dhentë.

"I këndomi një graxetë lal Tallarikut, ashtu e zgjomi e zë e mjel dhentë, bën gjizen dhe na jep edhe neve një lugë gjizë me hirrë, e hami e vemi përpara. Po mos hani shumë hirrë se mos ju dhëmb barku e s'mund t'vemi përpara. Nanì i qasemi te dera i këndomi këtë vjersh:

"Zgjohmu ti, lal Tallarik /se t'erdhëtin tij kater miq, zgjohmu e mil ti ato dhenë /se ata erdhin e të gjenë".

Lal Frangjisku Tallarikut u zgjua ka gjumi me këto kënga dhe duall pjot hare te dera skaracit, na sallutarti, muar thronin e u vu e moli dhent, dhezi zjarrin, bëri gjizen dhe na e dha me hirren; e pra u nistim e shkuam njeter herë ture kënduar njera n'maltë tek një vend ç'thuhet "Sheshi Lliut" mbrënda te Fagoza. Atje shkuam natën dhe fjetëtim mbi një lëkur dhensh e dhije. Dhe lal-zoti Manol ish si tat-madh i mirë për gjithë në dhe na mbësonej si kish t'duajem mirë malin, llakat, brinjat, përrenjet, qiellin, ilëzit, ajrin, kronjet dhe lulet e malevet tanë.

4. Dora e tij mbi shpatullen e besimtarëve

Kur ferrnua studimet në Romë bashkë me Viçenxinin Scarvaglion, ditën 26 Shën Marti 1962, erdhi te kisha Shën Thanasit, bashkë me lal-zotin papa Sepa Ferrari, pse në atë ditë bonxinjuri Jani Mele na vu duart mbi krie dhe na bëri priftra. Dhe lal-zoti Manol dhe lal-zoti papa Sepa erdhën e na mbajtën duart mbi shpatullat tona, rreth e rrotull autarit për tri herë, ture kënduar dhe ture parkalesur për ne. Doren e lal-zotit Manol mbi shpatullen time tek ajo ditë e shënjtë s'e harronj maj. Mua n'u duk si një fuqi e madhe dhe shpirtërore që m'vinej ngrah ka qielli edhe që më shtonej fuqitë dhe shëndeten kudo veja e kudo shkoja. Edhe sot, ture shkruajtur këtë kujtim, mua m'duket se ai edhe sot ecen afer meje si një udhëheqës i shënjtë, i mirë, i butë. Lal-zoti Manol më mban doren mbi shpatullen, ashtu edhe si ja mban, me shënjtërinë e tij si tat prift gjithë besimtarëve të katundit, ture sjellë dritë në jeten e tyre e perditëshme.

5. Brezi i ri me mbësime dhe me këngë te zëmra

Shkova një ditë m'këmbë dhe ka Frasnita, pas mjesditës, dhe vajta njera te qisha Shën Vasilit, Purçill. Zoti Manol ish mb'qish, e ulur te banket ish e bënej katekizmin krieturve, ç'kishen gjashtë, shtatë, tetë vjet. Ishen njëzetë. Lal-zoti Manol i folnej arbërisht mbi shurbiset e t'Inzoti, dhe ata i vëjen rë me di vesh haptë; dhe kur ai i pienej, ata i përgjegjshin mbjatu arbërisht. Dhe gjuha jonë arbëreshe zbukuronej dhe bënej dritë te trutë e te zëmra. Fjala e lal-zotit Manol ish e ëmblez, e thjështez dhe e butë dhe me t'qeshuren ndër buzë. Ture thënë e ture kënduar ato kënga qiellore, që ai vet i vënej në muzikë me një melodhi të jashtëzakonëshme, gjithë qisha bënej më shumë dritë. Ish një mësim si një uratë, si një gëzim, si një himn për të ardhmjen e këtore krieturave, fëmijëve, arbëreshë.

Brezi i ri, me mbësime dhe bekimet e lal-zotit Manol, kish kështu një rrënjë e thellë dhe e fuqishme, që edhe sot lulëzon dhe zbukuron gjithë katundin e Purçillit dhe e Frasnitës.

6. Kënga dhe gëzime ka lal-zoti Manol

Lal-zoti Manol mbjoj popullin tonë me dashuri dhe me njohuri për ritin tonë bizantinë, për liturgjinë tonë, për gjuhen tonë arbëreshe, për zakonet tonë. Ai mbjodhi fjalet e populli arbëresh dhe bëri Fjalorin, shkruajti Gramatika, themelloi revisten "Zëri i Arbëreshëve", shkruajti në muzikë shumë kënga popullore që edhe sot djemtë dhe vajzat e Arbërisë këndojnë në sheshe dhe në malet dhe në det. "Kush e bëri këtë këngë me këtë muzikë?". "E bëri zëmra dhe urtësia e lal-zotit Manol. Ai shkruajti edhe fjalet e prana i vu në muzikë e prana na i mbësoi për t'jemi të gëzuar në jeten tonë. E na i këndomi e bëmi harë kudo vemi".

7. Pedagogë shpirtëror

"Ngingi pas meje", i tha Inzot dishipulvet e tij. Dhe ata, lëshuan gjithsej dhe i vanë pas. Lal-zoti Manol bëri shumë dishipul te jeta e tij, si prift i katundit, pa thënë këto fjalë që tha Inzot.

Lal-zoti Manoli na buthtonej e na mbësonej shurbise të bukura vetem me vetëhenë e tij, me shëmbullin e tij, me shurbiset që thoj e që bënej afer neve, ditë për ditë.

Kështu trima dhe burra të martuara i vanë pas atij, me uraten e tij. Dhe muartin udhen e priftërisë për të shurbejen për shënjtërinë e për të miren e popullit arbëresh në katundet tanë.

Të gjithë këta pes o gjashtë priftra kanë patur si mësues dhe si pedagog i madh lal-zotin Manol. Madhështia e tij është dhe në këtë trashëgim shpirtëror dhe kulturor në priftrat tanë, që zbukurojen gjithë eparkinë tonë me episkopin tonë Donato në krye, shumë i dashur dhe i nderuar, që sot është shpirti dhe zëmra i Arbërisë sonë. Episkopi Donato bashkon shpirtërisht gjithë besimtarët arbëreshë, priftra dhe popull, që gjenden në katundet e Eparkisë arbëreshe bizantine.

8. Humanizëm i i lal-zotit Manoli

Venej e vinej lalzoti Manol dhe ka Cifti e ka Frasnita, ku gjindjat e dojen mirë dhe e prisjen me haré. Ai edhe kur venej e thonej meshen atje, këndonej aq shumë bukur sa gjindjat qindrojen me griken haptë. I qasej dhe folnej me gjithë dhe thonej fjalë t'urta me kripë e me val. Ai donej mirë besimtarët çivitjotë dhe frasnjotë si ata të Purçillit. Dhe dera e tij ish e haptë për gjithë, dimer e verë, natë e ditë.

9. Kuvendet e Arbërit te shpia e lalzotit Manol

Në vitin 1958 në muajin e gushtit, pas çë thojem lutjen e mbrëmjes te Qisha e Fjetjes në Frasnitë, lalzoti Sepa Ferrari, lalzoti Frangjisk Solano dhe unë, ç'isha student universitar në Romë, diljem e vejem gjithë Purçill te shpia e zotitlal Manoli, i cili na prit me hare dhe na vënej përpara trieses, ku ishen libra dhe shkrime, një mullun uji i madh di kile dhe i kuq i kuq. "Hani, vëllezer, se e mbajta nd'ujë dhe është si akull", na thoj lalzoti Manol. E ture ngrën mullunin e ture qeshur, binej fjala ngaherë mbi gjuhen tonë arbëreshe, mbi shkrimtarin prift Birnard Bilotta (1843-1918), mbi shkrimtarin prift Viçenx Dorsa (1823-1885), mbi shkrimtarin prift Jul Variboba (1724-1788), mbi shkrimtarin prift Frangjisk Ndon Santori (1819-1894). E veprat e tire dhe jeta e tire ish edhe biseda më e rëndësishme në këto triesa rrumbullakte ku në qendër ish kultura arbëreshe. Dhe lalzoti papa Manoli, lalzoti papa Sepa dhe lalzoti papa Frangjisku shtrijen tezat personale e tire. Mua këta takime vëllazërore m'dukshin si Kuvendet e Arbërisë ku lulëzonte Shpirti i Arbërit dhe ku lalzoti Manoli na prit me krahtë hapta e na shtonej fuqitë për ruajtjen e Gjakut tonë arbëresh dhe të Kombit tonë shqiptar, dhe të Qishës sonë bizantine arbëreshe në Kalabri nga shekulli XV.

10. Nëna Tereza dhe mons. Lush Gjergji

Da questa visione proviene anche un atteggiamento che deve coinvolgere tutti, ma particolarmente i pastori della Chiesa, per vedere *in ogni essere umano un riflesso divino*: non tanto che questi sia ricco o povero, sano o handicappato, zoppo, o cieco o sordo o muto, come vediamo spesso nei Vangeli attorno a Gesù Cristo. Ciò determina il rapporto di benevolenza, di amore, verso il prossimo. Ciò determina la relazione fraterna del pastore verso ogni membro del popolo di Dio. Soprattutto di quella parte di popolo a lui affidata.

c. In questa visione la tradizione bizantina mette in particolare rilievo *la benevolenza e la misericordia di Dio*. Moltissimi tropari del culto bizantino richiamano regolarmente e spesso la domanda della “*grande misericordia*” (*to mega eleos – Lipisinë e madhe*).

L'anafora di S. Giovanni Crisostomo – la più comune nella tradizione bizantina – mette in evidenza e in continuità la creazione, l'origine dell'uomo, e la redenzione come uomo nuovo.

Essa fa dire al celebrante rivolto a Dio: “*Tu dal nulla ci hai tratti all'esistenza e, caduti, ci hai rialzati; e nulla hai tralasciato di fare fino a ricondurci al cielo e donarci il futuro tuo regno*”. Dio Padre ha inviato il suo Figlio per riscattare e salvare il genere umano, per farlo rientrare nell'amicizia con Dio avviandolo sulla via del regno.

d. In questa prospettiva teologica, antropologica e soteriologica il credente bizantino, nonostante le difficoltà della propria, della comunità più prossima o della società in generale, matura un atteggiamento di fiducia in Dio, di serenità interiore, di *hesychia*, secondo la terminologia bizantina.

e. *L'esicasmo* – mi sembra di poterlo affermare con serenità, anche se titubante di fronte alla persona interessata – è una caratteristica fondamentale, maturata in papa-Manoli: serenità di spirito, benevolenza

nel rapporto con gli altri, bontà verso il prossimo. In questa dimensione – possiamo dirlo con gioia – egli è stato veramente bizantino. Egli ha reso presente quella serenità di spirito che proviene da una fede sicura, da una carità solida e da una speranza che riesce a vedere al di là delle spoglie pietre del Pollino e al di là della stessa collina della nostra esistenza. Penso che dobbiamo essergli grati per la sua testimonianza bizantina, cioè cristiana.

Papa-Manoli: un bizantino arbëresh.

5. Ma papa-Manoli è *un bizantino-arbëresh*. Non è un greco, non è un arabo, non è un russo, non è un romeno, non un georgiano o bulgaro o serbo – tutti bizantini – ma è un Arbëresh, è *un bizantino-arbëresh*.

a. Se ripercorriamo – anche velocemente – la sua biografia e la sua opera – altri con maggiore precisione e competenza lo faranno in questo stesso Convegno – incontriamo vari suoi lavori albanologici.

Segnalo alcuni: la raccolta del Folklore – usi e tradizioni della Pasqua a Frascineto ed Eianina (1957), la paziente raccolta del Lessico senza gli attuali supporti tecnici, e la pubblicazione (1963) del Dizionario degli Albanesi d'Italia – *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë*.

Preoccupato della crisi che attraversa l'Arbëria, in seguito, per l'apprendimento corretto della Lingua da parte delle nuove generazioni, redige una grammatica arbëreshe – *Gramatikë Arbëreshe* (2005); amplifica il *Dizionario Arbëresh-italiano* ed aggiungendo il *Vocabolario italiano-arbëresh* (2000). Se analizziamo questo *Fjalor*, vi riscontriamo una minuziosa raccolta di lemmi e d'espressioni, indagine che abbraccia tutto il patrimonio arbëresh scritto, ed anche quello trasmesso nelle parlate ancora vive dei vari paesi arbëreshë.

Inoltre partecipa attivamente al movimento di Risveglio Culturale tra gli Arbëreshë, colabora a varie Riviste (*Shejzat, Zgjimi*); dirige il periodico *Zëri i Arbëreshvet* (1972-1982), collabora al manuale in due volumi *Alfabetizzazione Arbëreshe* (2002), manuale per l'apprendimento della lingua arbëreshe; collabora ad altre iniziative volte a rafforzare la vita culturale degli Albanesi d'Italia.

Ma tutto questo non ha un fine a sè stesso. Constatiamo che questa ricerca è utilizzata per la vita della Chiesa: traduzione della Liturgia, traduzione di parti essenziali dell'Innografia, traduzione dei Vangeli.

Ha collaborato alla Traduzione ufficiale arbëreshe della *Liturgia Hyjnore* (1967) per le tre Circostrizioni Ecclesiastiche Bizantine in Italia; ha tradotto per il Giubileo dell'anno 2000 il *Vangelo di San Matteo*, che il Vescovo ha distribuito a tutte le parrocchie nelle sue visite pastorali; come si è detto, ora appare l'edizione completa dei *Quattro Evangelii* (2006). I Vangeli che si proclamano nelle domeniche e nelle grandi feste dell'anno liturgico, nella sua traduzione arbëreshe, attraverso il foglio "*E Diela*" (*La Domenica*), curato dall'Eparchia di Lungro, vengono divulgati in tutte le parrocchie arbëreshe. Il suo servizio raggiunge l'intera nostra Eparchia bizantino-arbëreshe. Su "Jeta Arbëreshe" sono in pubblicazione *le Ore* dell'ufficio bizantino.

Riscontriamo così l'applicazione fedele del principio bizantino per l'uso della cultura e della lingua del popolo come 'strumento per l'evangelizzazione e per il culto'.

b. Il Canto nella tradizione bizantina – lo sappiamo – è indispensabile nel culto. Un'iniziativa felice di papa Manoli è stata la traduzione dei tropari, dei principali inni usati nella liturgia (vespri, mattutini, Eucaristia, ufficio dei morti, matrimoni, ecc..) secondo il ritmo musicale, così che possano essere cantati in arbëresh.

Questa iniziativa ha un rapporto diretto col popolo. E' coinvolgente.

Per metterli al servizio degli altri, al di là della propria parrocchia, papa Manoli ha pubblicato gli inni tradotti in arbëresh e in musica bizantina: "*Himne liturgjike bizantino-arbëreshe*" (2005).

c. Le linee più significative che hanno guidato il suo ministero pastorale e la sua azione culturale, papa Manoli le ha presentate come proposte alla preparazione e celebrazione del II Sinodo Intereparchiale delle tre Circostrizioni Bizantine in Italia.

Osservazione conclusiva.

Per quest'altra via siamo ricondotti alla prospettiva di fondo che dà unità alla vita e all'azione di papa-Manoli. Ma anche al suo insegnamento pratico. "Ha insegnato agendo".

Per concludere, riporto l'inizio del tropario del 6 dicembre, da lui tradotto in albanese ed anche messo in musica: "*Esempio di fede e immagine di mansuetudine, ti designò al tuo gregge la verità dei fatti*". Questo tropario si addice anche a papa-Manoli. E per questo gli siamo grati. Gli sono particolarmente grato. Quando seminarista, orientato al sacerdozio, cercavo modelli, esempi a cui ispirarmi, spesso ho avuto davanti ai miei occhi l'allora giovane papas Emanuele.

Ju falenderonj, ju haristis – si thonë te Hora e Arbëreshvet, ndë Siqelì, ju ringraxjërinj, si thomi këtu – për paçenxën që kini pasur sa t'më gjëgjijt. Ma zoti Manol na dha me zëmer gjithë jetën e tij, mund t'japim pak mot sa t'thomi se e duami mirë. Faleminderit gjithëve. Dhe të fala gjithë katundit, pse papa Manoli nderon Ejaninën, Frasnitën e dhe tërë Eparkinë tonë. Për këtë, mirë bën Komuna, Bashkia e këtij katundi, t'e nderojë sot.

Grazie al Sindaco e al Comune, a tutti gli Enti che hanno promosso questa festa, e a tutti voi presenti che avete avuto la cortesia di ascoltarmi.

Ejanina-Frascinetto, 28-12-2006

Papas Emanuele Giordano: modello per un orientamento vocazionale

protopapas Nik Pace

purçilòt, Lecce

Introduzione

Sono particolarmente contento di essere qui con voi a festeggiare i 60 anni di vita pastorale del parroco di Ejanina Papas Emanuele.

Ringrazio gli organizzatori di questo incontro, che mi hanno chiesto di relazionare sull'aspetto spirituale, pastorale di quest'uomo, che è di Dio.

Cercherò perciò di tratteggiare, con emozione e gratitudine, questa figura sacerdotale che tanto ha inciso sulla mia formazione umana e spirituale, essendogli stato a fianco, prima come parrochiano e ora come confratello.

1. Sacerdote configurato a Cristo, Unico modello

Interpretando il pensiero di tutti, mi preme dire che per noi del paese, e per chi lo conosce e lo apprezza, lui è 'Zoti', intendendo con questo termine il padre spirituale, l'amico, il familiare, ma anche il segno della Grazia (con la 'g' maiuscola), perchè, quando c'è, infonde sicurezza, certezza di essere, con lui, accanto al Signore.

Sì, ciò che più colpisce, infatti di papas Emanuele è la tecnica adottata nel relazionarsi. E' un tempista perfetto: dopo pochi minuti di dialogo è già in sintonia con l'interlocutore, e per lui e con lui riesce a fare sintesi, discernere, andare all'essenziale, perchè in ciascuno si renda palese la volontà di Dio.

Sappiamo però che non ci sono scuole per affinare queste tecniche, e questo è solo il frutto di un attento servizio ai fratelli nell'arte dell'ascolto, che parte da molto più lontano e che si acquisisce dopo aver a lungo ascoltato Colui che crea, rinfranca, ricapitola in sè tutte le realtà nel sacrificio della Croce.

Solo alla scuola di questo Maestro, e pienamente configurati in Lui nel segreto della propria costante vita di preghiera, si può essere veramente all'opera per riproporre il Modello, (aneqefalòsasthe), ricapitolare appunto, come dicono i tecnici del sacramento dell'Ordine, mutuando un verbo usato da S.Paolo nella lettera agli Efesini (I,10), ogni realtà nel progetto di Dio, accettando il suo piano anche nei momenti più difficili della vita.

E' così che papas Emanuele è un consigliere perfetto, perchè con semplicità e discrezione orienta scelte particolari e difficili della vita, e, come nel mio caso, con forte grinta spirituale incoraggia a non esitare nel donarsi completamente a Cristo e alla sua Chiesa.

E' per questo suo esempio di vita di preghiera, e per queste sue particolari doti che, come me altri 5 giovani del paese, prima che ad un amico o ad un familiare, hanno confessato a lui la gioia intima di sentirsi chiamati a seguire Cristo nella radicalità della scelta sacerdotale.

Come me, Lorenzo, Basilio, Mario, Domenico e Vincenzo, sono stati incoraggiati da papas Giordano ad incamminarsi con fiducia sulla strada illuminata dalla Luce di Cristo, e seguire l'uso della Sua voce con nel cuore la certezza di essere sempre accompagnati dalla preghiera del loro parroco, quella preghiera che ha fatto sì che, per ognuno di noi 6, spunatsse l'alba del giorno in cui intorno all'altare insieme a lui si cantasse con gioia l'inno di consacrazione "Isaia horeve": Gezohu Isai, Virgjëresha dolli me barr...".

2. Il profeta.

In questo inno il profeta Isaia annunciava l'evento salvifico, la nascita di Cristo, dicendo al popolo d'Israele sconfortato: "Gioisci!"; lo stesso termine lo adopererà l'arcangelo Gabriele indirizzando il suo saluto alla Vergine, perchè in Lei il Verbo si faceva carne, i cieli si univano alla terra. "Gioite" è il termine profetico usato dal sacerdote quando, dopo la consacrazione, invita i fedeli a nutrirsi di Cristo, accoglierlo nella propria vita e dividerlo nell'amore al fratello, soprattutto quando questi è meno fortunato e nello sconforto.

E' di questo verbo, e invito alla gioia, che papas Emanuele ha fatto il suo programma di vita sacerdotale (un programma che incoraggia a seguire la GIOIA).

Con lui ho visto sfatata la vecchia concezione che voleva il sacerdote esperto solo nell'arte della compassione, ossia associare a questa figura l'uomo che condivide solo i dolori del mondo. Incredibilmente egli riesce ad essere portatore sempre di un sorriso, coniugando il fascino che esercita il Cireneo della croce all'idea che si possa essere Cirenei della Gioia.

Cireneo della Gioia pasquale, della vittoria di Cristo sulla morte.

E' proprio nei momenti più tristi che c'è lui, con la sua testimonianza di fede, pronto ad annunciare la vita. Questa incrollabile fede lo ha sostenuto anche quando la morte ha toccato i suoi affetti più cari, tra i quali, oltre ai suoi parenti, sono sicuro che vi è stato anche il mio papà, col quale si sono sempre scambiati opinioni in merito alla vita, che 'eterna' ha voluto il Signore per chi in lui ripone la sua fiducia.

Con lui non ci si annoia, soprattutto fuori dell'ufficialità dell'annuncio nelle omelie domenicali. La sua dinamica spirituale, nei grandi come nei piccoli, sbalordisce e rincuora ed è da esempio per me nel mio ministero.

Ricordo perfettamente le sue catechesi, c'era sempre una curiosità che teneva desta l'attenzione e poi il colpo di scena finale.

Da buon (..) e scrittore qual'è, riusciva a diventare completo gestore della fantasia dei più piccoli, esorcizzando le paure perchè si aprissero alla fiducia e alla speranza.

Mai, ad esempio, è stato saltato l'argomento della morte anche con i piccoli: mutuando detti e scene di vita popolare, 'Zoti' riusciva a comunicare dietro il velo dell'effimero le grandi cose di Dio, come la gratuità del dono sacro della vita, il rispetto che ad essa dobbiamo, nonché la fiducia nella misericordia divina e nel conforto dei fratelli, quando questa comincerà a vacillare.

L'incipit del suo discorso era: "Jemi si një kravele hua"; quando Dio vorrà, ritorneremo al Padre della vita, come il pane che, ricevuto in prestito, restituiamo con piacere al nostro benefattore.

In albanese riferiva scene di solidarietà accadute un tempo nelle gjitonie, (oscurando quelle di cui lui sicuramente in prima persona era il benefattore) facendo così passare con incisività il messaggio evangelico di fare della nostra vita, vissuta nell'amore fraterno, la 'vera offerta gradita a Dio', che nella morte trova il suo naturale passaggio verso il grande dono di Dio, che è l'eternità.

Ma per giungere a queste conclusioni vi erano tanti passaggi: innanzitutto la scena, la gjitonia, luogo di condivisione di vita fra vicini di casa; l'arte del fare il pane, la sua fragranza, forte richiamo a Bethleem, città del pane, e quindi a Cristo, nostro fragrante pane di vita. E poi fra i tanti passaggi vi era il viaggio del pane: preparato dalle mogli per i mariti e i figli pastori che trascorrevano lunghi periodi negli stalli di montagna; era il più piccolo dei figli ancora in casa a portarlo dal paese in montagna a dorso di mulo nella

notte fonda, inerpicandosi tra i monti tra sentieri tortuosi e con mille pericoli.

Ed è proprio qui che si inseriva la scena finale con un personaggio (kalogjeri) che raffigurava il male scacciato solo grazie alla 'disponibilità al bene' del bimbo e della sua famiglia.

Profeta e Cireneo della gioia, perchè è presente alle occasioni di festa nelle famiglie, soprattutto quando per essa si aprono nuovi orizzonti per il lieto fine di una vicenda che ha fatto tanto pensare.

Cireneo di gioia perchè è insostituibile compagno nelle passeggiate in montagna. Il periodo trascorso da fanciullo come pastorello nell'azienda montana del padre, lo ha reso fortemente familiare con ogni radura e ogni angolo del bosco, tanto da riconoscere quasi il respiro degli alberi.

Non esagero se dico che queste sono le occasioni più belle di preghiera con lui, perchè invita a lodare nel creato il suo creatore.

Momenti semplici quelli a cui ho fatto riferimento, ma che fanno pensare molto alla missione del sacerdote che ripropone in ogni evento la gioia di seguire Cristo, quel 'sì' detto all'invito di Dio e dire ad ogni fratello: "d'ora in poi le tue gioie saranno le mie gioie, spartirò con te il pane umano delle tristezze; mi lascerò coinvolgere dalle tue stesse speranze, e le tue angosce stringeranno pure a me la gola, con l'identico groppo di paura".

Il documento conciliare sulla Gioia (GS,1) formula questo sentimento dicendo: 'le gioie e le speranze, le tristezze e le angosce degli uomini d'oggi, dei poveri soprattutto e di tutti coloro che soffrono, sono pure le gioie e le speranze dei discepoli di Cristo, e nulla è di genuinamente umano che non trovi eco nel suo cuore".

3. Ministro della parola e dei sacramenti, modello di comunione.

La fraterna amicizia e la paterna sollecitudine del sacerdote scaturisce dal suo essere ministro della parola e dei sacramenti, perciò modello di comunione con la Chiesa tutta.

Le parole e il pane spezzato con i fedeli segnano il ritmo quotidiano di vita del sacerdote, e per quanto in questo campo si possa dire, la cosa che più conta è ciò che lascia l'impronta della grandezza di questo evento e il come questo viene celebrato, con quale partecipazione lo si vive...

E qui non posso non rendervi partecipi di quanto di più caro conservo nel mio ricordo, di quando chierichetto scrutavo, servendo all'altare, le mani rugose di zot Emanuele che spezzavano il pane consacrato. Mi sembra ancora di percepire la solennità del momento per la delicatezza del gesto, ma anche per la forza di chi nella gestualità di quel momento voglia ri-centrare davvero la sua vita e la vita del popolo a lui affidato intorno al Signore Gesù.

La profonda dimestichezza con la Parola di Dio qui diventava accoglienza senza sconti delle esigenze più radicali e più coinvolgenti del Vangelo.

Era nelle mie considerazioni di fanciullo un momento magico, perchè non solo si verificava un miracolo, il pane diventava Cristo, ma affiorava come per incanto anche un discepolo: mi chiedevo, allora, se questo mai sarebbe successo anche a me.

Quale responsabilità scaturisce da quell'evento?

Ogni responsabilità, prima fra tutte il senso di comunione, con la Chiesa tutta, partendo dal suo sentirsi fortemente legato al presbiterio locale e al suo vescovo, offrendo una testimonianza che sicuramente stimola la riflessione di chi vuole essere costruttore di forte comunione intorno a Cristo.

Come sacerdote, sento e vedo quale grande responsabilità gravi sul nostro essere testimoni di unità, perchè

soprattutto nel contesto eparchiale dove tante particolarità, rito, lingua, impostazioni pastorali, metodologia, dislocazione dei centri, si sommano per creare spesso divergenze, tra i sacerdoti che non creano nè forza, nè qualità di vita migliore.

La sua testimonianza vuole esserle innanzitutto per un presbiterio cementato dalla parola di Dio, compatto intorno all'altare, come pronto al perdono e al servizio fraterno, sempre disponibile. Per tutta la vicaria est dell'Eparchia, Papas Emanuele è un decano di riferimento. Un protos.

Una testimonianza di riferimento per una unità tra tutti i cristiani, anche di altre confessioni, un impegno che quotidianamente è ripreso in parrocchia, creando un vero osservatorio di carità sulle aperture fraterne verso l'unità della Chiesa in Albania e in Grecia.

Conclusion

“Va' e anche tu fa' lo stesso!”, dice Gesù ai suoi discepoli, quando, con la parabola del buon Samaritano, insegnava il servizio ai fratelli, al prossimo, inculcando il senso del dono e della carità.

Nella figura del samaritano emerge infatti non tanto il gesto, ma la cura nell'effettuare tale gesto, quasi a dire 'Fate in modo di essere alla stessa maniera attenti, non tanto alle opere di carità quanto alla carità delle opere', facendo in questo trasparire la bellezza di Dio.

In questo DON EMANUELE CI È RIUSCITO.

(Frasineti 28-12-2006)

Edhe një herë ju falemnderit !**Motra e vogël Maria Lucia**

Tiranë

Më 28 dhjetor 2006, me këto fjalë motra e vogël Maria Lucia ka përshëndetur në emrin e motrave të vogla Zot Emanuelin në rastin e 60 përvjetorit të pranisë së tij si famullitar në Ejaninë.

Zot Manuel,

po ju sjell përshëndetje të përzemërta nga motrat e vogla së bashku me një falënderim shumë të ngrohtë. Falemnderit për besimin me të cilin në 1969 keni pranuar dëshirën e motrës së vogël Magdeleine që donte të hapej në Ejaninë Vëllazëria e motrave të vogla. Menjëherë keni kërkuar një familje ku do të strehoheshim ditët e para, dhe familja e dhën Vasilin na ka çelur derën e shtëpisë dhe derën e zemrës. Pastaj tërë fshati u bë për ne një familje dhe çdo shtëpi na hapi derën e vetë dhe zemrën e vetë.

Falemnderit për ngrohësinë e pritjes suaj nga dita e parë e ardhjes sonë: nuk harroj kurrë drekën e parë që kemi ngrënë pranë oxhakut, me shokun tuaj të dashur, profesorin Pace.

Falemnderit për dëshminë e fesë suaj të kthjellët dhe gazmore, si një rënie uji të freskët që shuan etjen dhe qëndron edhe pas shumë vitesh, si drita në ecjen pas Jezusit.

Falemnderit që na keni mësuar si të marrim frymë edhe me mushkërinë e Lindjes, dhe atë me mënyrë të ndryshme, me tërë qenien tuaj, me mësimet mbi Liturgjinë dhe me shpjegimet e shumta dhe kjo në jetën e përditshme.

Falemnderit për mësimet e para të gjuhës shqipe në sallën e famullisë me dërrasën e zëzë dhe shkumës!

Falemnderimi i fundit, që për mua i përmbledh të gjithë të tjerët, për shembullin e qartë dhe të kthjellët të fëmijerisë shpirtërore që na keni dhënë me tërë jetën tuaj. Jezusi në Ungjillin na thotë që mbretëria e tij është hapur për të vegjëlit: ju gjithmonë keni ditur të bashkoni thjeshtësinë e të vegjëleve me Urtesinë dhe Diturinë.

Edhe një herë ju falemnderit !

motra e vogël Maria Lucia

Ejaninë 28 dhjetor 2006

Kontributi i Emanuil Xhordanit në Leksikografinë Arbëreshe

dr.prof.Imri Badallaj

Universiteti i Prishtinës

Ndër leksikografët e parë, që i kishte hyrë punës me një dorë të mbarë, qe Frang Bardhi me fjalorin e tij: *Dictionarium latino-epiroticum* (1635), që, edhe pse nga vëllimi ishte vepër e vogël, për nga rëndësia përbënte një vepër gjuhësore me rëndësi të madhe; kështu që, pas këtij shembulli, vjen e rritet interesimi dhe vargu i autorëve, sot arrin numrin 500. S’do mend se ky numër kaq i madh i veprave të këtij lloji është produkt shkencor, që kërkoi dije dhe mund të pakursyer.

Një punë e tillë, jo edhe e lehtë në hartimin e fjalorëve, nuk mungoi as ndër radhët e vëllezërve tanë arbëreshë, që për fat të lig disa prej kontributeve të tyre mbetën sot e kësaj dite në harresë në formën e dorëshkrimit. Mirëpo, disa kësosh u botuan, dhe si të tillë erdhën e u bënë shtyllat më të qëndrueshme të murit të madh të leksikografisë sonë, sepse ata ngërthejnë në vete vlera të pakontestueshme të një karakteri të mirfilltë shkencor.

Në kuadrin e produktivitetit të leksikografisë arbërore, pa dyshim vend të merituar zë Fjalori zulmëmadh i Emanuil Xhordanit, i botuar më 1963 versioni i parë, dhe versioni i dytë më 2000, me titullin *Fjalor i Arbëreshëve të Italisë*.

Versioni i dytë ndryshon pak për nga vëllimi, sepse zgjërohet me shtojcën e leksemave të gjuhës italiane të ndjekura me përkthimin në arbërishte. Ky pa dritën e botimit mu në çastin kur arbërishtes i nevojitej më së shumeti. Dua të them se ky Fjalor arriti në tryezën e punës shkencore të leksikografëve, atëherë kur në një anë ruatja dhe kultivimi i arbërishtes fitoi një kujdes më të theksuar, dhe në anën tjetër, kur asaj i kanosej një vërshim i paparë i fjalëve me origjinë të gurrës së huaj.

Fjalori për të cilin po bëjmë fjalë u hartua nga ky erudit i vyer dhe fort i madh në letrat e shkencës, që si i tillë, duke punuar pandërprerë edhe natën e shëndërronte në ditë, me një qëllim të vetëm, për të na dhuruar një varg kontributesh, si: nxjerrjen dhe drejtimin e revistave, mbledhjen dhe botimin e bëgatësisë folklorike dhe publicistike, krijimtari letrare të të gjitha zhanreve, përkthime të literaturës fetare dhe artistike, muzikologji; por gjithësi në gramatologji dhe në leksikografi është më i dalluar.

Ky prodhim shkencor në kaq shumë fusha këtë autor e bënë të madh, të qëndrueshëm, dhe si të tillë e vendos në stadin e merituar. Sidomos Fjalori dhe Gramatika do t’u vijnë në ndihmë të gjithëve atyre, të cilët do të kenë punë jo vetëm me arbërishten, por me mbarë shqipen. Prandaj studjuesi i leksikografisë shqiptare, pa e konsultuar dhe pa e përpunuar shkencarisht këtë vepër të madhe linguistike, gjithsesi do të ndihej sa i varfër, aq edhe i penguar për të hyrë në fushën e gjuhësisë shqiptare.

Fjalori i Xhordanit ngërthen në vete një lëndë leksikore të arbërishtes shumë interesante dhe të bëgatë, që shlrshëm mund të shprehemi se kjo vepër leksikore është një çelës, që pa të s’mund të hapësh asnjë derë e deriçkë në segmentet leksikore të gjuhës shqipe.

Fjalori i Arbëreshëve të Italisë është dygjuhësor, por fjalësi dhe mbarë natyra gjuhësore e shtruar mbrënda 750 faqeve, jo vetëm të zgjon kërshërinë, por ai të merr e të bën për vete në tërësi, që në asnjë mënyrë më kurrë s’mund t’i ndahesh, ngase kjo vepër përmbleh në vete rreth 20.000 fjalë arbëreshe dhe fut në përkthim hiç më pak se 11.000 fjalë italiane, çfarë tregon se kjo vepër është edhe një hulumtim e studim përfaqësues, që për pasqyrimin e ndërndikimeve të këtyre dy gjuhëve ngërthen një lëndë fort të bollshme dhe shumë interesante, sepse autori eksploron fjalësin e shumë sferave të mbarë jetës dhe realitetit arbëresh.

Kjo vepër leksikografike është pasqyra më e ndritur dhe më e realtë e integritimit të proceseve gjuhësore të komunitetit arbëresh, e sidomos u dedikohet jo vetëm studiuesve dhe hulumtuesve të arbërishtes, por edhe të të gjithë të rinjve që dëshirojnë ta nxënë dha ta studiojnë këtë gjuhë, e cila për fat jo të mirë në disa segmente të saj ka filluar të zbehët.

Dukuria e mosnxënies së arbërishtes, autorit i është ngulitur thikë në zemër e në shpirt, prandaj për disa dekada të tëra si një bletë punëtore që mbledh nektarin e luleve për ta bërë mjaltin e saj, ky dijetar i ndritur mbledh: fjalë, frazeologjizma, idioma, zhargone, sintagma e shprehje nga më të skajshmet, vetëm e

vetëm për ta ngritur këtë monument gjuhësor, çë Xhordani e ka pagëzuar: “Fjalor i Arbëreshëve të Italisë”. Pra ky duajen (gigante?) i dijes sonë, i përkushtuar dhe i pakursyer në punën e tij kërkimore-shkencore, pruri dritë në korridoret e arbërishtes, të cilët kishin filluar të pushtohen nga terri i dhëmbit të kohës.

Fjalësi i veprës në fjalë pasqyron begatinë gjuhësore të arbërishtes: në veprat letrare, në përralla e tregime, në aktet administrative kishtare dhe jo kishtare, në ligjërimin e gjallë, që si i tillë paraqet një thesar gjuhësor fort të çmuar, që për ata të cilët bëjnë punë shkencore në fushat gjuhësore e më gjerë, është një shtys për pëgatitjen e fjalorëve të mëpastajme të arbërishtes, sepse leksikografia e gjithë shqipes, pa njohjen e fjalësit të arbërishtes, do të jetë e mëngët, e varfër dhe e paplotë, dhe jogarantuese për një rritje dhe zhvillim të mëtejshëm, çfarë do të thotë se për shqipen vepra në fjalë paraqet një dhunti të veçantë, aq më tepër kur dihet mirëfilli se vetë arbërishtja brenda letrave të saj, edhe sot e kësaj dite me një ambicje të paparë, ruan fjalë e shprehje që rrallëkund mund t'i gjejmë.

Fjalori i Emanuil Xhordanit është hartuar duke respektuar një metodologji shkencore, që tani në gjuhësinë e përparuar është bërë parim dhe domosdoshmëri. Ajo çka është e rëndësishme se autori në këtë Fjalor mbarë fjalësinë e tij e ballafaqon me italishten, që ky ballafaqim nuk kufizohet vetëm në rrafshin semantiko-leksikor, por prek edhe disa zhvillime të tjera, qoftë të natyrës fonetike ose të asaj gramatikore, që gjithsesi kjo trajtesë ngjall interesimin e atyre që do ta kenë nëpër duar këtë vepër me vlera jashtëzakonisht të veçanta.

Identifikimi i fjalëve nga pikëpamja semantike, Fjalorit i jep dimension sa shkencor, aq edhe tërheqës për përdoruesit e tij, ngase kjo i nxit ata, që sa më lehtë dhe sa më shpesh t'i nxënë dhe t'i përvetësojnë fjalët dhe shprehjet nduarnduarta dhe fort të mrekullueshme të arbërishtes.

Treguesit fonetikë dhe gramatikorë, të dhënat për karakterin etimologjik dhe shënuesit për vlerat e përdorimit të fjalëve vijnë e shtojnë vlerën e Fjalorit, sepse të interesuarit e kësaj vepre nuk mund të jenë vetëm folës të thjeshtë, po përkundrazi kjo është një produkt shkencor që ka një dedikim më të gjerë seç tregon vet titulli mbi kopertinat e tij. Prandaj, kur merren parasysh të gjitha këto kritere, që u është pëmbajtur autori në hartimin e tij, si dhe materia e pëmbledhur në të, me plot gojë do të them se ky Fjalor i autorit tonë do të rrojë dhe do të udhëtojë, jo vetëm me arbërishten, por me mbarë shqipen dhe si i tillë sjell pasurim gjuhësor, si në cilësi ashtu edhe në sasi brendapërbrenda shtrukturës leksikore të shqipes, çë në nxënien e arbërishtes dhe të italishtes, për studime kontrastive, për dialektologjinë, për sociolinguistikën, për ndërkërkimet gjuhësore, për fonetikën, për gramatikën, për historinë e shqipes dhe mbi të gjitha për leksikografinë, Fjalori i Xhordanit është dhe do të jetë gurthemel dhe i një vlere të veçantë linguistike.

Në fund e përmbyll këtë kumtesë timen me një dëshirë: që autori i këtij Fjalori – zoti Emanuil Xhordani – të na rrojë edhe 100 vite të tjera, që shkencës dhe kulturës arbërore, gjuhës dhe dijes sonë, “gjakut tonë të shprishur”, t'i dhurojë edhe shumë e shumë vepra të tjera, që na duhen si buka!

Kontributi i E. Xhordanit për gjuhësinë arbëreshe

dr.prof.Italo Costante Fortino

Università "L'Orientale", Napoli

0. Parathënie

Më duket se gjithë na që u mblodhimit bashkë sod do të dimë atë që bëri Zoti Emanuel Xhordani ndë 60 vjetët që shkoi Ejaninë si prift, si bari, dhe si studhioz, pse ai, thomse, ndë gjithë katundet arbëreshë, dhe jo vetëm ndë katundet arbëreshë, njihet si një prift që shkruajti libra për gjuhën arbëreshe.

Me këto pakë fjalë që vete ture thënë, dua të buthtonj pse Zoti Emanuel pati kaq nderes për gjuhën dhe për kulturën arbëreshe, pra që kontribut i dha lesikografisë dhe gramatikës arbëreshe; pëstaj thom dy fjalë për tradhucjunat (përkthimet) arbëreshe që ai bëri; dhe ndë fund që gjuhë manioi (përdori) kur ai shkruajti arbëresh.

1. Nderësi per kulturën dhe gjuhën arbëreshe

Zëmi nga e para pikë: Pse Zoti Emanuel u nderesar për gjuhën dhe kulturën arbëreshe.

Nëng mund ish një'etër shortje, pse Eparkia e Ungrës, që është një Eparki e re, - u kriua, si dimë, ndë vitin 1919 – kish bzonj të formohej me identitetin e saj, i cili identitet ka dy elemente të para, kryesore: ritin bixantin dhe kulturën arbëreshe.

Ndonjeri mund të thetë: po pse, datu se është prift, nëng u nderesar vetëm për ritin e vate të birij mot edhe per kulturën e për gjuhën arbëreshe?

Priftrat janë si misionarë dhe si misionarë ata ku venë e predhikarin ka t'e njohin mirë kulturën e gjuhën e gjindjes ku ata gjënden. Edhe Qisha katolike e Romës mbëson se misioni që një prift bën ndë një vend ka t'inkarnaret (mishërohet) ndë kulturën e vendit, dhe ka t' njoh gjuhën e vendit ku zvullxhin (zhvillon) misionin.

Zoti Emanuel këtë e bëri mirë pse jo vetëm njohu gjuhën e kulturën arbëreshe për misionin e tij ndë katundin Ejaninë, si edhe ndë gjithë Eparkinë, po studhioi më thellë se mudi kulturën dhe gjuhën arbëreshe se të raforcarij identitetin e Eparkisë së Ungrës. Finaliteti (qëllimi) i tij qe të krearej një Eparki komplate, e çementuar mirë, me një kulturë me armoni, me një gjuhë që na dhanë prindët, si edhe me prinçipe (parime) të krishterë që na erdhën të trazmetirtur (trashiguar) me ritin oriental bixantin.

Vjen me thënë se mesaxhi i krishter shkon ndëpërmjet kulturës; dhe gjindja e merr më mirë ndëse e gjegjën ndë gjuhën që flet nga ditë.

Mesaxhet e Vangjelit Zoti Krisht nëng i dha me parabolla? Ai bëj kështu pse gjindja palestineze e motit të tij shurbiset i kuptoj më mirë me parabolat; nd'atë mot flitej ashtu: me parabolla. Mesaxhi pra inkarnaret ndë kulturën e vendit.

Pëstaj Zoti Emanuel mbajti përpara syve një'etër indikacjunë që i vij nga Konçili i Vatikanit të dytë. "Kostitucionat e Dekretet" të Vatikanit të dytë, kur flitet për Qishat Orientale Katolike, thotë se "intexjuna e Qishës katolike është se kanë të rrinë të shpëtuara, të tëra dhe të paprishura tradhicjunat e çdo Qishe".

Pëstaj ndëse na vemë e shohim që thotë edhe Dekreti mbi ativitetin misionar të Qishës, djovasim këto fjalë: "Priftrat, misionarët ka t' njohin thellë, storjen, struturat soçiale si edhe tradhitat e gjindjes...".

E një cik më atej thotë më mirë e më qartë se

"Zotrat ka t' mbësojin gjuhën e vendit aq mirë se t'e maniojin me shpejtësi dhe me korretecë, sepse vetëm kështu mund të arvojin më lehtë tek mendja e tek zëmra e njerëzvet".

Me një'etër ca fjalë mund thomi se Zoti Emanuel kish besë se, për t'e kuptohen mirë njerëzt, është bëzonj të njihet mirë gjithë bëgatria kulture dhe gjuhësore e gjindjes arbëreshe.

Ky program i Zotit Emanuel, si thashë, ka dy aspete pozitive: 1) arvon e flet më mirë mendjes e zëmrës së gjindjes; 2) jep një kontribut të madh komunitetit të katudit dhe komunitetit më të gjerë të Eparkisë, pse e raforarën ndë identitetin kultural dhe shpirtual.

2. Kontributi per lesikografinë

Nga herë që Arbëreshët u mblodhtin në konvenj – kujtojm dy Kongreset e De Radës Koriljanë (1895) dhe Ungër (1987) – përfunduan se ish bëzonj të mblidhej gjithë bëgatia e fjalëve arbëreshe se të stamparej nje Fjalor arbëresh. Shumë studhioz përvuan t’e bëjin këtë fëtig – mbajim mend atë që bëri Ark. Pietri Kamodeka, Zoti Bernard Bilota, o Aristi Manes, si edhe dica të tjerë – por mosnjeri bëri një të kërkuar komplet. Vetëm fortësia dhe kompetenca e Zotit Emanuel arvoi të na jipij në vitin 1963 Fjalorin e Arbëreshvet t’Italisë.

Për këtë Fjalor foltim këtu Ejaninë dica vjet prapa e nani nëng ripëtirinj (përsërinj) atë që thashë. Sod ju thomë vetëm se është një oper vërtet e madhe që qëndron në storjen e kulturës dhe në storjen e gjuhësisë arbëreshe e pati një ehò (jehonë) jo vetëm në gjithë katundet arbëreshë - ku ndodhet njeri që nderesaret për gjuhën dhe kulturën arbëreshe - por në gjithë jetën shkencore arbëreshe dhe shqiptare.

Është i pari Fjalor që na jep jo vetëm tradhuckjunën (përkthimin) e fjalës arbëreshe, por Autori çitan edhe frazat (fjalitë) të marra nga autorët arbëreshë që në operat e tyre uzarin atë fjalë.

Nj’etër shërbes që ka t’ mbajim mend është se ky Fjalor na jep edhe sinonimet; vjen me thënë jo vetëm një sinjifikat (domethënie), ma gjithë domethëniet që një fjalë ka në gjuhën arbëreshe.

Për Fjalorin qëndronj këtu. Nj’etër herë mund të flasim si mund të bëhet edhe më i bëgat me nj’etër edicjunë, ture i shtuar distinxjunën e fjalëvevet që maniohen edhe sod në katundet arbëreshe e të fjalëvevet që maniuar vetëm autorët e që nëng hyjtin në të folurit e gjindjes. Por ka t’ kemi më shumë mot se të flasim vetëm për këtë problem. Këtë e bëjim nj’etër herë.

3. Kontributi për Gramatikën arbëreshe

Nj’etër kontribut që dha Zoti Emanuel Xhordani është Gramatika arbëreshe që doli vjet e që më duket se në pakë paxhina (faqe) Autori arvoi e sintetixoi e sistemarti elementet e para (kryesore) të kategorive të gramatikës arbëreshe. Janë dica studhioz arbëreshë që thonë se nëng mund t’mbësohet gjuha arbëreshe e se ka t’ mbësohet gjuha që shkruhet sod në Shqipëri, sepse tek ne nëng ezistin një gjuhë arbëreshe unike, e ka shumë variante e nëng dihet cila ka t’ mbësohet.

Zoti Emanuel me këtë Gràmatikë na buthton se, megjithëse të folurit arbëreshë kanë dica variante, mund të individuaret një gjuhë, që thërresim “gjuhë komune” (e përbashkët), që ka forma që mbahen edhe sod të ndrequra mirë, si edhe ka fjalë të vjetra që bëgatën edhe gjuhën e Shqipërisë.

Për këtë aspet, mund çitarinj librin që shkruajti Prof. Miço Samara nga Tirana, Fjalorth krahinor me fjalë shqipe (Tirana, 2005), ku Autori vë shumë fjalë që kemi na Arbëreshë e që në Shqipëri nëng ezistirin. Ai i mblodhi e i proponirën se t’i maniojin skritorët shqiptarë në operat e tyre.

Zoti Emanuel shkruan se “ka të folur arbëreshë ku sintasa u mba më mirë se në ndica tjerë të folur, e pak mangon se është një (e njëjta) me atë të Shqipërisë; kështu edhe lesiku është i pastër e i afrohet lesikut të gjuhës shqipe”.

Pëstaj edhe në format e kategorivët të morfologjisë, nga njera anë vlon ata forma më arkaike, më të vjetra që kanë pothuaj gjithë të folurit arbëreshë, si format e xhenitivit e dativit plural (shumës) me artikullin –t, për esemp: duarvet, kronjevet, e jo pa –t-në në fund si është sod në gjuhën shqipe sepse atje u buar; dhe në shqipe forma indeterminate (e pashquar) është gjithë një me formën determinate (e shquar); o edhe ablativi determinativ që del me –shit (es. burrashit, maleshit, forma që u buartin në gjuhën shqipe); nga jetra anë kur Autori sheh se forma më e maniuar, më e përdorur është ajo inovative, dhe se është kjo ajo që përdoret edhe në shqipen, e buthton si formë të përbashkët, megjithëse shënon edhe format më të vjetra. Kështu desinencat e imperfetit: u kisha (si në gjuhën shqipe e si në shumë të folur arbëreshë, mbrej formës kishnja (më e vjetër) o formës sinkopate kinja. Nga këto pak esempe ndijohet se nën kësaj gramatike, që butthohet e thjeshtë, ka një studim dhe një sistem nderesant për gjithë ata që duan të shkruajin arbërisht e duan të jenë të ndijuar (të kuptuar).

4. Përkthimet arbërisht

Ndë vitin 2000 Eparkia e Ungrës botoi vullumin “Vangeli i Shën Matesës”, që është tradhucjuna arbërisht e këtij Vangjeli e bërë nga Zoti Emanuel.

Dhja këto ditë doli nga stampa “Vangjeli” arbëresh i tërë; vjen me thënë të katërt Vangjejt, ndë një edicionë të bukur e shumë pratike, që gjithë familët arbëreshe ka t’ kenë.

Ture ruajtur tradhucjunën që bëri Zoti Emanuel, ndonjeri mund t’ na lipinjë ndë cilën gjuhë arbëreshe e bëri këtë tradhucjunë, ndë cilin arbëresh?

Po më parë se t’i pergjegjem këtij të pyetjuri, është mirë të thomë gjë mbi tradhucionën që një komisionë bëri ndë vitin 1967 të “Liturgjisë hyjnore të Joan Hrisostomit”, vjen me thënë mbi tradhucionën e “Meshës arbëreshe”.

Tradhuciuana e “Liturgjisë hyjnore” është bërë ndë një arbëresh që i afrohet shumë gjuhës letrare të Shqipërisë. Por ka të thomi se vlon shumë karakteristika të arbërishtes. Ju bënj dica esempe:

- kemi desinencën –nj, te veta e parë indikativ present, ndë vend të formës së palatalizuar –j, si është sod ndë gjuhën letrare shqipe; kështu afronj e jo afrojt;

- desinencën e imperfetit tek e treta vetë: -nej, ndë vend të –te: kështu puthnej e jo puthte;

- desinencën –e ndë vend të –esh ndë të dytën vetë indikativ present të formës medio-pasive; kështu lavdërohe e jo lavdërohesh.

Variante i gjëjim ndë lesikun, por, sipas dicave, mund u kishin vënë më shumë fjalë arbëreshe ndë vend të atyre shqipe.

Ka t’ thomi edhe se gjëjim jo ngaherë uniformitetin ndë lesikun. Ky shërbes na thotë se edhe tradhucjuna e Liturgjisë ka t’ bëhet më mirë, ka t’ përmirësohet. Vetëm një esemp: gjëjim tek e njëjta paxhinë (faqe) nani fjalën mbretëri e nani rregjëri, me të njëjtin sinjifikat (domethënie).

Shohim nani atë që bëri Zoti Emanuel ndë tradhucjunën e Vangjelit. Mua më duket se ture e konfrontatur (krahasuar) me atë të Liturxhisë, kjo e Vangjelit është më e kuptueshme, ndjohet më mirë, ka fjalë që edhe sod thuhet nga gjithë.

Kur një test nënj ndjohet, nënj vjen me thënë se janë format e gramatikës që nënj ndjohet, por janë fjalët, është lesiku që ndryshojn e që nënj ndjohet..

E ndë lesikun Zoti Emanuel pati vëmendje, qe syhapët.

Sa t’ e verifikojim sosën të djoasim një copë nga Vangeli i Shën Mateut: Kapitulli 12, Verseti 33. Shihni se është kaq i kulluar që mund e ndjohin gjithë:

“Ndëse mirrni një arzur të mirë, edhe fruti i tij do të jetë i mirë; ndëse mirrni një arzur të lig, edhe fruti i tij është i lig; sepse nga fruti njihet arvuri. Rracë nëprëmtesh, si mund të thoni shërbise të mira ndëse ju jini të ligj? Sepse nga burimi i zëmrës flet gryka “.

Me këtë tradhucjunë të Vangjejt, mund të thomë se Zoti Emanuel raforcarti udhën e arbërishtes së shkruar të përbashkët.

Edhe sod janë dica arbëreshë – si xha ju thashë - që thonë se është difixhull (e vështirë) të shkruhet arbërisht, për dy motive:

1. i pari, se të folurit arbëreshë kanë shumë variante e nënj dihet cila ka t’ zgjidhet;

2. i dyti, se lesiku që kemi nënj sosën për të esprimirim (shprehim) gjithë atë që duam.

Janë dy probleme të vërteta që nganjëri që merr e shkruan arbërisht përpyk ndë udhën e të shkruarit. Por një rrugëdalje është.

Zoti Emanuel bëri kështu: përpara varianteve ai zgjodhi formën më korrete. Ai thërret korrete formën që përputhet me gramatikën e kodhifikuar. Ky është një tentativ të gjëndet një kompromis që afron të folurit arbëresh me gjuhën shqipe.

Për lesikun që nënj sosën, ai mori, më parë, fjalët e vjetra që thushin një herë e që sod u harruan, pra kur

edhe këto fjalë nëng sosin, mori dica nga shqipja.

Edhe ky të zgjedhur është një kompromis që afron arbërishten me shqipen.

Mua më duket se ture bërë kështu, nga njëra anë, kemi një gjuhë që mund t'ë ndiojin, ndëse jo gjithë arbëreshët, së paku 80% i Arbëreshëve, nga jetra anë raforçarim gjuhën arbëreshe, kontribuirim sa të krijohet një gjuhë e shkruar e përbashkët.

Sa t'ë fërnonj dua të thom se Zoti Emanuel ndë gjithë atë që bëri ndë fushën e kulturës mbajti ngaherë përpara syve, ndë vendin e parë, problemin shpirtual: sa t'i arvoi gjindjes me një mesaxh që mund t'ë ndiojin ndë gjuhën e tyre. Këtë mesaxh, kur gjindja e gjegjën ndë gjuhën që flet nga ditë, e ndjon e e aqetarën (pranon) më mirë, më lehtë.

Ndë vendin e dytë, mbajti përpara syve kulturën e katundit, kulturën e Eparkisë, pse kjo kulturë ka shumë vlerë, pse kontribuin të ndjohen më mirë shërbiset, dhe pse mban bashkë gjithë gjindjen që bën pjesë. Me një fjalë raforçarën identitetin e çdo katundi e identitetin e të tërë Eparkisë.

IL CONTRIBUTO DI EMANUELE GIORDANO ALLA LINGUISTICA ARBËRESHE

Notevole il contributo dato dal Papàs Emanuele Giordano alla linguistica arbëreshe. Dominante, in primo luogo, il suo interesse per la cultura arbëreshe in senso lato, finalizzato alla sua missione di guida spirituale e di pastore.

Gli ambiti prescelti in campo linguistico sono: 1. La lingua e la cultura arbëreshe; 2. La lessicografia; 3. La grammatica arbëreshe; 4. Le traduzioni in arbëresh; 5. La formazione di un arbëresh scritto.

1. La lingua e la cultura arbëreshe

L'interesse per la lingua e la cultura arbëreshe scaturisce da due ragioni:

- a. consolidamento dell'identità culturale, linguistica e spirituale dell'Eparchia bizantino-cattolica di Lungro, oltre che della comunità parrocchiale di Eianina;
- b. comunicazione nella lingua e cultura della comunità parrocchiale.

Il Decreto Vaticano sulle Chiese Orientali Cattoliche recita: "E' intenzione della Chiesa cattolica che rimangano salve e integre le tradizioni di ogni chiesa". Il Decreto sull'Attività Missionaria della Chiesa aggiunge: "I preti missionari conoscano a fondo la storia, le strutture sociali e le consuetudini della gente";

"Apprendano la lingua della gente tanto bene da poterla usare con speditezza e proprietà. Sarà questo il modo per arrivare più facilmente alla mente e al cuore degli uomini".

2. La lessicografia

Alla fine dell'800 è stata avviata la raccolta del lessico arbëresh, promossa dai due congressi di Girolamo De Rada (Corigliano C. 1895; Lungro 1897): protagonisti l'Arch. Pietro Camodeca de' Coronei e il Papàs Bernardo Bilotta. L'opera è stata realizzata dal Papàs Emanuele Giordano nel 1963 con il "Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë". Essa rimane una pietra miliare nella storia della lessicografia arbëreshe, indispensabile per studiosi e semplici interessati alla lettura dell'arbëresh. Il "Fjalor" riporta la traduzione dei lemmi in italiano ed è caratterizzato dalla presenza della fraseologia, tanto della lingua viva che delle opere degli scrittori arbëreshë, e dalla sinonimia.

3. Gramatikë Arbëreshe

E' un tentativo di sistematizzazione delle categorie grammaticali dell'arbëresh per un processo di definizione di un modello di lingua scritta arbëreshe. Principi di fondo: a) conservazione di elementi arcaici scomparsi nella lingua letteraria d'Albania; b) individuazione di elementi comuni con la lingua d'Albania.

4. Traduzioni in arbëresh

a) Traduzione in arbëresh del "Vangjeli i Shën Matesë" (2000); b) e del "Vangjeli" (2006).

Rispetto alla traduzione in arbëresh della "Liturgia Hyjnore e Joan Hrisostomit", le traduzioni dei Vangeli del Giordano sono più comprensibili dagli arbëreshë, per l'utilizzo di un lessico più accessibile. E' un tentativo di superamento delle varianti arbëreshe in un processo di formazione di una lingua comune arbëreshe con oculute scelte di forme linguistiche. In presenza di più varianti arbëreshe il traduttore ha privilegiato quella comprensibile anche in Albania.

Nel lessico il traduttore ha utilizzato: a) il patrimonio lessicale arbëresh vivo; b) in assenza di lessico vivo e di quello arcaico arbëresh ha attinto alle forme della lingua letteraria.

Dei prestiti romanzi ha conservato solo quelli più acclimatati.

Le traduzioni in arbëresh di Emanuele Giordano sono un contributo notevole al consolidamento di una lingua scritta arbëreshe comprensibile.

Zoti Lalë, dekani i Eparkisë

Agostino Giordano

drejtor i *Jetes Arbereshe*, ka Purçilli (Cs)

U, sonde, s'kish folja fare, sepse s'më nget.

Po dy fjalë kam i thom. Një si drejtor i *Jetës Arbëreshe*. E njetër si nip.

Jeta Arbëreshe, rivistë çë del Purçill, u le ndë janar 2002. Te ky muaj, shëndrë 2006, mbaron pesë vjet e pesëdhjetë numëre. S'bëmë festë tek i pari numër, s'bëmi festë tek i pesëdhjetëti numër. Sepse s'na pëlqen të folmi, na pëlqen të bëmi. Mund t'jetë se Jetën Arbëreshe e festomi Purçill, sa të ndreqet Salloni ' Qishës. Atjë i ka hjë t'i bëhet festë një rivistje purçilote.

Jeta Arbëreshe u le e rron se të ruanj identitetin arbëresh, po paremëparë Gjuhën Arbëreshe. Për këtë është e shkruar arbërisht. Është një rivistë për Arbëreshët. Njera dje dil një herë ndë muajit, soteparet një herë nga dy muaj. Një zgjedhje çë më mbëshoi shumë, po nani ka të verë kështu.

Nër katër libret e sprasëm çë shkruajti zotilalë, tre ja botoi, si 'Shtojca', revista Jeta Arbëreshe. E janë: *Himne Liturgjike Bizantino-arbëreshe* të vitit 2005; *Vangjeli dhe Mbledhje këndimesh Arbëreshë*, të vitit 2006, o - më mirë të thomi - të këtyre ditëve. Tre libre çë nderojën Rivistën, Eparkinë e Arbërinë.

Zotilalë s'do të bënjë si 'zotilalë pjak' (papas Bernard Bilotta, stërlala i tij), çë la shumë veptra arbëreshe të pabotuara. Jo, veptrat e tij zotilalë dishëron t'i botonjë nani ç'është i gjallë. "Ç'bën vet, kë", thot fjala e urtë. Po edhe pse e shtijta u, t'i botonej. Dhe e ndiha sa munda.

Zotilalë, dhjetra vjet prapë, kish pregatitur 'Gramatikën Arbëreshe' dhe e mbanëj këtë; ka vitra vej ture mbjedhur, e tue vënur në muzikë, 'Kënka Folklorike dhe Kalimere' të Purçillit e të Frasnitës, o çë këndohen te këta dy katunde; ka vitra vej tue pjerrë arbërisht 'Himne Liturgjike greke' dhe i vënej në muzikë bixantine. Si pra u dolla (2002) me rivistën Jeta Arbëreshe, zu e botoi arbërisht, numër pas numri, pak e pak, Vangjelin e Shën Markut, Gramatikën Arbëreshe, dhe Himnet. Kështu, vjet (2005), më parë botoi librin Himnet Liturgjike, e pra Komiteti për Pakicat Gjuhësore (i drejtuar ka P.Bruni) i botoi librin Gramatikë Arbëreshe. Po u, fare i ndëndur, i thash:"Zotilalë, Mbledhjen e Kënkavet Folklorike dhe të Kalimerevet mund t'thuash se e mbarove; Vangjelin e Shën Markut e mbarove; Vangjeli i Shën Mateut, i vitit 2000, do vet ndërruar pak: pse nani nëng prier arbërisht edhe Vangjelet e Shën Llukës dhe të Shën Janjit, e pra i boton të katër bashkë?". Më tha:"Ëh". E, ç'atë ditë, zu e shërbei ditë e natë – e u me të – për këta dy libre. Çë sot kemi këtu përpara.: Mbledhje këndimesh Arbëreshë e Vangjeli. Një punë e rëndë, për një njeri normal. Një mërakull, për një "trim tetëdhjetegjashhtë vjetsh", si zotilalë!

Me pak fjalë: zotilalë jetën e tij ja kushtoi dy Idealeve: Qishës Bixantine dhe Kulturës Arbëreshe.

